



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria- Vlada- Govenrment

Ministria e Financave dhe Transfereve
Ministarstvo za Finansije i Transfere
Ministry of Finance and Transfers

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023

Prill 2020

Lista e shkurtesave

AAP	Arsim dhe Aftësim Profesional
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKP	Agjencia Kosovare e Pronave
APRK	Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BAKT	Bruto të Ardhurat Kombëtare të Disponueshme
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
BRE	Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë
ERA	Agjenda për Reforma Evropiane
EUROPOL	Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në Zbatimin e Ligjit
FAK	Forcat e Armatosura të Kosovës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
IAL	Institucionet e Arsimit të Lartë
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IFACCA	Federata Ndërkombëtare e Këshillave të Artit dhe Agjencive të Kulturës
IFN	Institucionet Financiare Ndërkombëtare
IHD	Investimet e Huaja Direkte
INTERPOL	Organizata Ndërkombëtare e Policisë
IPA	Instrumenti për Asistencë Para-Anëtarësimi
IPSHESH	Institucionet Jo Përfutuese në Shërbim të Ekon. Shtëpiake
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KfE	Kreditanstalt für Wiederaufbau
KTD	Korporatat Tjera Depozituese
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
MFSK	Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NP	Ndërmarrjet Publike
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
PKRE	Programi Kombëtar për Reforma në Ekonomi
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

PRE	Programi i Reformave Ekonomike
RSSS	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SISH	Sistemi Informativ Shëndetësor
SKZH	Strategjia Kombëtare Zhvillimore
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim
SMIL	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Lëndëve
SHSKUK	Shërbimi Spitalor, Klinik Universitar i Kosovës
TI	Teknologjia Informative
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNESCO	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë
USAID	United States Agency for International Development
ËEO	World Economic Outlook

Përmbajtja

PJESA E PARË	8
1. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME TË QEVERISË 2021-2023.....	8
PJESA E DYTË	23
2. KORNIZA MAKRO-FISKALE	23
2.1. KORNIZA MAKROEKONOMIKE	24
2.1.1 AMBIENI I JASHTËM EKONOMIK.....	24
2.1.2. ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE NË KOSOVË.....	26
2.2. KORNIZA FISKALE 2021-2023	36
2.2.1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET QEVERTARE.....	36
2.2.1.1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET NË VITIN 2020	36
2.2.1.2. PARASHIKIMI I TË HYRAVE PËR PERIUdhËN 2021-2023	36
2.2.1.3. PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN 2021-2023	38
2.2.2. DEFICITI BUXHETOR DHE RREGULLA FISKALE	43
2.3. RREZIQET AFATMESME 2021-2023	48
PJESA E TRETË	54
3. KORNIZA E SHPENZIMEVE SEKTORIALE 2021-2023 – QEVERTIA QENDRORE.....	54
3.1 QEVERTIA E PËRGJITHSHME	56
3.2 MBROJTJA.....	57
3.3 RENDI, LIGJI DHE SIGURIA PUBLIKE.....	59
3.4 ÇËSHTJET EKONOMIKE	61
3.5 MJEDISI.....	63
3.6 ÇËSHTJET E BANIMIT DHE KOMUNITETIT	64
3.7 SHËNDETËSIA	66
3.8 REKREACIONI, KULTURA DHE RELIGJIONI	67
3.9 ARSIMI	69
3.10 MBROJTJA SOCIALE	71
PJESA E KATËRT	73
4. NIVELI KOMUNAL	73
4.1. HYRJE	73
4.2 BURIMET E FINANCIMIT KOMUNAL PËR VITIN 2021-2023.....	73
4.2.1 GRANTI I PËRGJITHSHËM.....	73
4.2.2 GRANTI SHITESË PËR FINANCIMIN E KRYEQYTETIT	76

4.2.3	GRANTI SPECIFIK PËR ARSIM PARAUNIVERSITAR	76
4.2.4	GRANTI SPECIFIK PËR SHËNDETËSI PRIMARE	79
4.2.5	FINANCIMI PËR SHËNDETËSI SEKONDARE	80
4.2.6	FINANCIMI PËR SHËRBIMET REZIDENCIALE.....	80
4.2.7	FINANCIMI PËR QENDRËN HISTORIKE TË PRIZRENIT, QENDRËN KULTURORE TË FSHATIT ZYM DHE KESHILLIN E HOÇËS SË MADHE	80
4.2.8	FINANCIMI PËR ZONËN E RREZIKUAR MJEDISORE TË OBILIQIT	81
4.2.9	FINANCIMI PËR TEATRO	81
4.3	PROJEKSIONET E TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE PËR VITIN 2021 DHE PARASHIKIMET 2022-2023.....	81
4.4	KLAUZOLA E INVESTIMEVE.....	82
4.5	PËRMBLEDHJE E FINANCIMIT KOMUNAL PËR VITIN 2021-2023	83

HAPËSIRË INFORMUESE 1. KRAHASIMI I PARASHIKIMEVE MAKROEKONOMIKE NË KASH-ET E MËHERSHME ME AKTUALET.....	29
--	----

HAPËSIRË INFORMUESE 2. KRAHASIMI I PARASHIKIMIT MAKROEKONOMIK PËR KASH-IN 2021-2023 ME INSTITUCIONET E TJERA	35
---	----

HAPËSIRË INFORMUESE 3. KRAHASIMI I PARASHIKIMEVE BUXHETORE DHE AKTUALEVE PËR VITIN 2019	37
--	----

HAPËSIRË INFORMUESE 4. PAKO EMERGJENTE FISKALE SI PËRGJIGJE NDAJ SITUATËS SË EMERGJENCËS SË SHËNDETIT PUBLIK (COVID-19)	41
--	----

HAPËSIRË INFORMUESE 5. DEVIJIMET KRYESORE NDËRMJET KASH-VE 2021- 2023 DHE 2020- 2022 PËR VITET 2021 DHE 2022.....	43
--	----

Grafiku 1 Rritja ekonomike reale në vendet e tjera	25
Grafiku 2 Diversifikimi i eksporteve.....	27
Grafiku 3 Bilanci i llogarisë rrjedhëse	28
Grafiku 4 Tregu i punës.....	28
Grafiku 5 Kreditë, depozitat dhe kreditë jo-performuese	29
Grafiku 6 BPV-ja sipas komponentëve BPV-ja sipas komponentëve	33
Grafiku 7 Struktura e të hyrave në të hyrat e të përgjithshme	36
Grafiku 8 Struktura e shpenzimeve buxhetore	39
Grafiku 9. Trendi i Borxhit të Përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së	46
Grafiku 10 Rritja ekonomike reale, v-m-v, %.....	49

Tabela 1 Disa Indikatorë Ekonomikë	32
Tabela 2 Projeksionet e të hyrave.....	38
Tabela 3 Struktura e Shpenzimeve	39
Tabela 4 Borxhi i Përgjithshëm.....	44
Tabela 5 Borxhi ndërkombëtar përfshirë edhe borxhin e zotuar e të padisbursuar sipas 31.12.2019	45
Tabela 6 Analiza e ndjeshmërisë së buxhetit ndaj luhatjeve të variablave makroekonomike për 2021- 2023	50
Tabela 7 Detyrimet e papagura	52

Tabela 8 Pagesat bazuar në vendimet gjyqësore (milion Eur).....	53
Tabela 9 Trendet e Financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021-2023.....	54
Tabela 10 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023 për nivelin qendror.....	55
Tabela 11 Trendet e Financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Qeverisja e Përgjithshme.....	57
Tabela 12 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023 –Sektori i Mbrojtjes	58
Tabela 13 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023 – Sektori i Rendit, Ligjit dhe Sigurisë Publike	61
Tabela 14 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i çështjeve ekonomike.....	62
Tabela 15 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Mjedisit.....	64
Tabela 16 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Çështjeve të Banimit dhe Komunitetit.....	65
Tabela 17 Trendet e Financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Shëndetësisë	66
Tabela 18 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Rekreacionit, Kulturës dhe Religjionit.....	68
Tabela 19 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Arsimit.....	70
Tabela 20 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Mbrojtjes Sociale.....	72
Tabela 21 Përcaktimi i vlerës së Grantit të Përgjithshëm për komuna 2021-2023 (mil. Euro)	74
Tabela 22 Struktura e Grantit të Përgjithshëm për 2021-2023 sipas LFPL (mil. Euro).....	74
Tabela 23 Shpërndarja e Grantit të Përgjithshëm nëpër komuna 2021-2023	76
Tabela 24 Shpërndarja e Grantit shtesë për financimin e Kryeqytetit 2021-2023	76
Tabela 25 Shpërndarja e grantit specifik për arsim, për vitin 2021-2023	79
Tabela 26 Granti specifik për Shëndetësi primare, për vitin 2021-2023.....	79
Tabela 27 Financimi për shërbime rezidenciale për vitin 2021-2023	80
Tabela 28 Financimi për Teatro për vitin 2021	81
Tabela 29 Projektionet e të hyrave vetanake komunale për vitin 2021-2023	82
Tabela 30 Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2021-2023 (mil. euro).....	83
ANEKS 1	88
ANEKS 2.....	97

Hyrje

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 (KASH 2021-2023) paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet Buxheti Vjetor për vitin 2021. Qëllimi kryesor i KASH-it është që të ofrojë një analizë, e cila reflekton mjedisin makroekonomik në vend, për të vendosur kështu bazën për planifikimet buxhetore për vitet që vijnë në përputhje me prioritetet strategjike të Qeverisë.

Duke marrë parasysh strukturën aktuale ekonomike të Kosovës dhe pengesat e shumta në rritje ekonomike, është e nevojshme ndërmarrja e reformave ekonomike për të liruar dhe fuqizuar potencialin ekonomik të vendit. Prioritetet e reformave ekonomike për periudhën afatmesme burojnë nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Programi për Reforma në Ekonomi 2020-2022, i cili rrjedh nga procesi i dialogut për qeverisje ekonomike ndërmjet Kosovës dhe BE-së.

Qeveria vazhdon të ketë si objektiv kryesor forcimin e mëtejshëm të pozitës së saj fiskale dhe menaxhimit të përgjegjshëm të financave publike. Në këtë kontekst, planifikimi dhe ekzekutimi i buxhetit do të bëhet në linjë me rregullën fiskale të vendit që e kufizon deficitin buxhetor në 2% të BPV. Duke pasur parasysh se ky rregull paraqet një kufizim kur konsiderojmë nevojat e Kosovës për projekte të mëdha zhvillimore, implementimi i ‘Klauzolës për Investime’ i mundëson Qeverisë të financojë projekte kapitale me interes të gjerë publik, mbi deficitin prej 2% të BPV, me kusht që këto projekte të financohen nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare dhe Agjencitë Zhvillimore.

KASH 2021-2023 përmbledh këto prioritate kyçe të qeverisë në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme dhe pastaj në kapitujt përkatës, që mbulojnë të gjithë sektorët buxhetorë, duke përshkruar qasjen se si do të sigurohen fondet për zbatimin e tyre nga buxheti i Kosovës dhe asistencat financiare ose huatë nga partnerët zhvillimorë.

KASH 2021-2023 është e strukturuar në katër pjesë kryesore. Pjesa e parë përmban “**Deklaratën Afatmesme të Prioriteteve**”, e cila ofron një përmbledhje të gjerë të prioritetëve të Qeverisë në përputhje me Programin Qeverisës, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Programin e Reformave në Ekonomi. Në pjesën e dytë është **korniza makro-fiskale** bazuar në parametrat e përgjithshëm të zhvillimit ekonomik. Në pjesën e tretë dhe të katërt janë paraqitur **parashikimet fiskale** të cilat përcaktojnë kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve mbi bazën e të cilave përgatitet më vonë Buxheti Qendror dhe ai Komunal.

PJESA E PARË

1. DEKLARATA E PRIORITETEVE AFATMESME TË QEVERISË 2021-2023

Objektivat e Përgjithshme dhe Korniza Fiskale

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 paraqet dokumentin kryesor mbi bazën e të cilit do të hartohet buxheti vjetor për vitin vijues 2021. Qëllimi kryesor i përcaktimit të prioriteteve është që të bëhet ndërlidhja duke u bazuar analizën gjithëpërfshirëse të mjedisit makroekonomik në vend dhe planifikimeve buxhetore për vitet vijuese me një perspektivë 3(tre) vjeçare në përputhje me objektivat strategjike të Qeverisë.

Objektivat strategjike të Qeverisë së Kosovës janë përcaktuar nëpërmjet dokumenteve të ndryshme strategjike, përkatësisht Programit të Qeverisë, dokumenteve strategjike si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe strategjitë sektoriale, si dhe dokumentet që rrjedhin nga procesi i integritimit evropian sikurse Programi për Reforma në Ekonomi dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Objektivat kryesore të Programit të Qeverisë 2021-2023 theksojnë se prioritetet e Qeverisë duhet të fokusohen në këto fusha: i) drejtësi; ii) ekonomi dhe punësim; iii) arsim; iv) shëndetësi; v) siguri; vi) integritime euro-atlantike; dhe vii) mjedis.

Ekonomia konkurruese është shtyllë kryesore e çdo zhvillimi dhe krijimit të vendeve të punës. Duke marr parasysh strukturën aktuale ekonomike të Kosovës dhe pengesat e shumta ndaj rritjes ekonomike, në veçanti situatën e krijuar si pasojë e pandemisë globale COVID 19, është i domosdoshëm orientimi i reformave strukturore që kanë qëllim rimëkëmbjen e ekonomisë në përgjithësi. Për këtë qëllim, Qeveria do të ndërmarrë vlerësimet nevojshme të ndikimit të krizës së pandemisë në ekonomi dhe do të marr masa të vazhdueshme për rimëkëmbjen e ekonomisë, duke konsideruar edhe mbështetjen e vazhdueshme të partnerëve zhvillimorë.

Politikat fiskale të planifikuara në KASH dhe PRE mbështesin rritjen ekonomike dhe agjendën e reformave strukturore, duke siguruar që shpenzimet për investime publike shkojnë në mbi 10% të BPV-së dhe, përveç përmirësimit të infrastrukturës në transport, përfshijnë edhe investime në institucionet arsimore dhe shëndetësore, bujqësi dhe zhvillim rural, ujitje dhe trajtim të ujërave të zeza. Buxheti për vitin 2021 përfshin rritje substanciale të financimit për fushat prioritare si: reformën e gjyqësorit, ngritjen e cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë, sektorin e bujqësisë dhe mbështetje për sektorin privat.

Procesi i aderimit të Kosovës në Bashkimin Evropian është i rëndësishëm jo vetëm për zhvillim ekonomik, por gjithashtu për përmirësimin e qeverisjes dhe institucioneve të vendit, si dhe për integritimin politik dhe ekonomik ndërkombëtarë dhe sigurinë e vendit. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian (BE) është kornizë kontraktuale e detyrueshme e procesit të aderimit të Kosovës në BE. Në këtë drejtim, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit vendos kornizën planifikuese afatmesme për përmbushjen e detyrimeve të MSA-së.

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023, përmbledh këto prioritete kyçe të Qeverisë së Kosovës në Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme dhe pastaj në kapitujt përkatës, që mbulojnë të gjithë sektorët buxhetorë, duke përshkruar qasjen se si do të sigurohen fondet për zbatimin e tyre nga buxheti i Kosovës dhe asistenca financiare ose huat nga partnerët zhvillimorë.

Dy kapitujt e parë të Deklaratës së Prioriteteve Afatmesme paraqesin kornizën e përgjithshme fiskale për tri vitet e ardhshme dhe parimet themelore mbi të cilat bazohet ajo. Kapitulli i tretë paraqet një përmbledhje të prioriteteve të Qeverisë bazuar në dokumentet kryesore planifikuese, si: Programi i Qeverisë, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe strategjitë sektoriale, Programi për Reforma në Ekonomi dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Struktura e kapitullit të tretë është bërë në atë mënyrë që të përafrohet me strukturën e sektorëve të KASH.

Prioritetet kryesore do të udhëzojnë të gjitha organizatat buxhetore në përgatitjen e propozimeve të tyre buxhetore për vitin 2021. Sipas këtyre prioriteteve, organizatat buxhetore mund të përfshijnë propozime për finalizimin ose racionalizimin e programeve ekzistuese në mënyrë që të mundësohen fondet për ato programe që paraqesin prioritet të lartë, duke përfshirë propozimet për politika të reja. Në raste të veçanta, propozimet mund të përfshijnë kërkesa për financim shtesë nëse kërkesa të tilla demonstrojnë ndikim të lartë në arritjen potenciale të objektivave dhe prioriteteve të Qeverisë.

1.1 Korniza e përgjithshme fiskale për prioritizim

Programi i Qeverisë 2020-2023, Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021, Programi për Reforma në Ekonomi 2020-2022, dhe Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës dhe BE-së janë dokumentet kryesore që përcaktojnë orientimin dhe zhvillimin e politikave qeveritare dhe që sigurojnë bazën për përcaktimin e prioriteteve të politikave në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2021-2023.

Qeveria vazhdon të ketë si objektiv kryesor strategjik stabilitetin makroekonomik dhe zhvillimin e politikave fiskale, të cilat sigurojnë qëndrueshmëri, zhvillim ekonomik dhe klimë më të favorshme të të bërit biznes, që mundëson zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit privat. Qeveria e Kosovës do të jetë e përkushtuar në mbarëvajtjen, forcimin dhe transparencën e mbarëvajtjes së financave publike duke ndërmarrë këto masa:

- Sigurimi i zbatimit të disiplinës fiskale me qëllim ruajtjen e stabilitetit makrofiskal;
- Harmonizimi i legjislacionit në fushën e financave publike në harmoni me obligimet e MSA-së (Acquis) dhe me standardet ndërkombëtare;
- Ngritja e efikasitetit të alokimit në menaxhimin e parasë publike, në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore për qytetarët;
- Ngritja e efikasitetit operacional në menaxhimin e parasë publike, në harmoni me rregullat dhe standardet në fuqi;
- Sigurimi i financave publike të shëndosha, përmes reformave në Menaxhimin e Financave Publike dhe bashkëpunimit me Institucionet Financiare Ndërkombëtare;

Objektivat kryesore të strategjisë fiskale për periudhën 2021-2023 vazhdojnë të jenë:

1.1.1 Menaxhimi i financave publike: Në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria dhe rritja ekonomike, Qeveria e Kosovës do të ndërmarrë disa hapa konkretë në këtë drejtim, si: (i) rritja e pragut të të ardhurave personale jo të tatueshme, e cila do të bëhet përmes shqyrtimit të politikave fiskale dhe ndryshimit të legjislacionit përkatës; (ii) rishqyrtimi i kornizës ligjore dhe institucionale në funksionim të mbledhjes së të hyrave në brendësi të territorit të shtetit; (iii) ulja e pragut të transaksioneve në para të gatshme, në mënyrë që të intensifikohet lufta ndaj evazionit fiskal, e cila do të rezultonte në trajtim të drejtë të subjekteve ekonomike, rritje të të hyrave tatimore dhe formalizim të punësimit; (iv) sigurimi i llogaridhënies për shfrytëzim më efektiv të parasë publike; (v) rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të prokurimit publik, duke fuqizuar prokurimin elektronik, dhe rritja e transparencës së tenderimeve publike.

1.1.2 Mjedisi biznesor dhe zhvillimi i ndërmarrësisë: Ky objektiv synon mbështetjen institucionale të ndërmarrjeve, si një prej motorëve kryesorë të rritjes ekonomike në Kosovë, duke siguruar një mjedis të barabartë, duke hequr monopolet, duke eliminuar evazionin fiskal, duke siguruar furnizimin me energji elektrike me çmim të përballueshëm dhe, veçanërisht, duke realizuar në kohë pagesat për ndërmarrjet që kryejnë punë të kontraktuara nga autoriteti publik. Gjithashtu, ky objektiv është i fokusuar edhe në ndërmarrjet publike, duke synuar përmirësimin e menaxhimit dhe performancës së tyre.

Themelimi i Gjykatës Komerciale synon të krijojë siguri juridike për bizneset vendore dhe investitorët e huaj. Kjo gjykatë do të ketë prioritet krijimin e një mjedisi sa më efikas, ku bizneset dhe investitorët do t'i zgjidhin kontestet e tyre me shpejtësi dhe cilësi. Në fokus të saj do të jenë eliminimi i barrierave të të bërit biznes, fuqizimi i sektorit privat, thjeshtësimi i procedurave për pajisjen me leje dhe licenca, dhe finalizimi i reformës së përgjithshme të inspektimeve.

Për më tepër, zhvillimi i sektorit privat do të bazohet fillimisht në formalizimin e bizneseve dhe punësimit. Në përgjithësi, synohen politika zhvillimore ekonomike, të cilat rrisin dhe mbrojnë prodhimin, fuqinë blerëse, zgjerojnë tregun, luftojnë korrupsionin dhe krimin, rrisin numrin e vendeve të punës dhe konkurrueshmërinë e sektorit privat. Qeveria do të ketë fokus të veçantë nxitjen dhe lehtësimin e investimeve të huaja, posaçërisht duke eliminuar pengesat për investimet e huaja. Përmes këtyre politikave do të krijohen kushte të veçanta për investimet e huaja dhe për zhvillimin e politikave tregtare në përputhje me detyrimet ndaj MSA-së. Gjithashtu, këto politika do të dizajnohen në mënyrë që t'i bëjnë eksportet një shtytës të rritjes dhe zhvillimit duke rritur prodhimin, inovacionin dhe konkurrencën. Në këtë drejtim, do të përmirësohet korniza ligjore në fushën e tregtisë së brendshme dhe të jashtme, në fushën e tregtisë elektronike dhe në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale.

1.1.3. Tregu i punës dhe punësimi- Ky objektiv ka si prioritet përmirësimin e shërbimeve të punësimit, rritjen e efektshmërisë së masave aktive të tregut të punës, përmirësimin e të drejtave të punëtorëve dhe garantimin e standardeve minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë. Kjo do të bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare nëpërmjet përmirësimit të kornizës ligjore,

përkatësisht ligjit të punës dhe atë për inspektoratin e punës, dhe nëpërmjet zhvillimit të sistemit informativ për tregun e punës.

1.1.4. Avancimi i politikave në sektorin e bujqësisë: Synohet të definohen kritere të qarta dhe transparencë e plotë, duke u fokusuar në rendiment e jo në sipërfaqe – konform rrethanave ekzistuese për rritjen e produktivitetit dhe cilësisë që rezulton në rritje të konkurrueshmërisë. Prioritet do t'i jepet rritjes së transparencës në aplikimin, vlerësimin, monitorimin/inspektimin, dhe pagesën e subvencioneve dhe granteve. Gjithashtu, zhvillimi i ndërmarrësisë agro-përpunuese, së bashku me nevojën për zhvillimin e shkathtësive në sektorin e industrisë së ushqimit do të trajtohen me prioritet. Si pasojë e rritjes së kërkesës për profesione në industrinë e përpunimit të ushqimit, duhet të konsiderohet trajtimi i hendekut të mundshëm ndërmjet shkathtësive dhe nevojës për zhvillim të standardeve profesionale në këtë sektor.

1.1.5. Prioritizimi i investimeve të shkallës së gjerë për infrastrukturë moderne dhe atë të energjisë– Prioritizimi do të bëhet sipas shkallës së ndikimit në transformimin e strukturës ekonomike në vend. Infrastruktura energjetike, transporti rrugor, hekurudhor dhe ajror , rrjetet e ujësjellësit, ujitjes, trajtimi i ujërave të zeza, do jenë projekte prioritare në përbërjen e buxhetit. Investimet në energji planifikohen të kryhen edhe me përfshirjen e sektorit privat përmes reduktimit të kostove të energjisë që do të ndihmojnë bizneset dhe do të nxisin më tej investimet private.

Objektivat e lartëpërmendur trajtojnë të gjitha organizatat buxhetore në mënyrë të barabartë, prandaj është i domosdoshëm avancimi i bashkëpunimit në nivel të Qeverisë, në mënyrë që të mund të përcillet agjenda e zhvillimit ekonomik të vendit duke ruajtur stabilitetin makro-fiskal.

1.2 Parimet themelore

Procesi i përgatitjes së parashikimit të shpenzimeve për periudhën 2021-2023 udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- Përputhje më të madhe me politikat prioritare të Qeverisë të dhëna në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021, Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2020-2022, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit si dhe Programin e Qeverisë 2021-2023. Udhëzimet për prioritetet specifike janë dhënë më poshtë;
- Alokimin e shpenzimeve të cilat janë më efektive në realizimin e objektivave të politikave të Qeverisë;
- Arritjen e vlerës më të madhe për fondet e shpenzuara duke realizuar synimet specifike prioritare, nëpërmjet zhvendosjes së fondeve drejt prioritetëve të nivelit të lartë;
- Ndërlidhjen me financimin e jashtëm i ofruar përmes IPA dhe kanaleve të tjera;

1.3. Fushat prioritare

Qeveria e Kosovës paraqet deklaratën e mëposhtme të prioriteteve në lidhje me KASH 2021-2023. Prioritetet janë paraqitur në mënyrë specifike duke u bazuar në dokumentet kryesore strategjike, në veçanti Programin e Qeverisë së Kosovës, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, Programin për Reforma në Ekonomi 2020-2022, si dhe Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Deklarata është gjithashtu e bazuar në dokumente të tjera strategjike sektoriale, duke iu mundësuar organizatave buxhetore një masë të fleksibilitetit për të përcaktuar strukturën më të përshtatshme dhe nivelet më adekuate të financimit për të arritur këto qëllime.

Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesave të tyre buxhetore për vitin 2021 me parashikimet për periudhën afatmesme (2021-2023), nga organizatat buxhetore pritet të tregojnë se si plani i tyre buxhetor i përgjigjet prioriteteve të Qeverisë të paraqitura më poshtë. Prioritetet janë paraqitur për të gjitha sektorët e Qeverisë, duke adresuar kështu çështjet më të rëndësishme që Qeveria duhet të fokusohet gjatë periudhës së ardhshme tri vjeçare. Kundrejt prioriteteve të dhëna, organizatat buxhetore inkurajohen që të përmirësojnë efikasitetin në shpenzime përmes rialokimit brenda kufijve ekzistues.

1.3.1. Qeverisja dhe administrata publike

Në periudhën afatmesme Qeveria do të vazhdojë me prioritet të lartë të zbatoj reformën e administratës publike. Në këtë drejtim, me prioritet do të jenë: përmirësimi i planifikimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave, ngritja e transparencës dhe llogaridhënies, përmirësimi i menaxhimit të financave publike, integriteti dhe profesionalizmi i shërbimit civil dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve, duke përfshirë gjithashtu reformat në qeverisjen lokale.

- **Planifikimi, politikëbërja, llogaridhënia dhe transparenca** – fokus kryesor është përmirësimi i planifikimit strategjik, rritja e cilësisë së planifikimit sektorial me tregues të performancës, duke avancuar kështu praktikën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave. Zhvillimi i politikave të bazuara në të dhëna do të mbështetet duke aplikuar metodologjinë për vlerësimin e ndikimit të politikave të ndërmarra. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve institucionale për të zhvilluar statistika të besueshme, në përputhje me praktikën dhe standardet evropiane. Këto do të mbështeten gjithashtu duke rritur transparencën, përfshirjen e qytetarëve, mediave, shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin e politikave. Qeveria do të mbështet procesin e *zvogëlimit të barrës administrative, duke eliminuar burokratitë e tepërta* e posaçërisht duke bërë thjeshtësimin, eliminimin ose bashkimin e lejeve dhe licencave.
- **Menaxhimi i financave publike** – në përputhje me kornizën strategjike dhe obligimet në kuadër të agjendës së integrimit evropian, do të sigurohet zbatimi i prioriteteve në kuadër të një politike të gjithanshme makrofiskale, që siguron qëndrueshmëri dhe rritje ekonomike. Politikën fiskale do të orientohen në atë mënyrë që të sigurojnë mbështetje për sektorët ekonomikë që janë ndikuar nga kriza e pandemisë gjatë vitit 2020. Për të siguruar trajtim të drejtë të subjekteve ekonomike, rritje të të hyrave tatimore dhe formalizimit të punësimit, Qeveria do të intensifikojë luftën për eliminimin e evazionit fiskal. Për më tepër, me prioritet

do të trajtohet përmirësimi i performancës financiare dhe llogaridhënies së ndërmarrjeve publike.

- **Modernizimi i administratës publike** – duke u bazuar në obligimet në kuadër të dialogut të politikave të zhvilluara me BE-në, Qeveria do të vazhdojë mbështetjen e modernizimit të administratës publike. Do të mbështetet zbatimi i kornizës ligjore për administratën publike, përkatësisht ligjet zyrtarët publik dhe pagat në sektorin publik, duke përfshirë edhe racionalizimin e agjencive. Për të rritur kapacitetin dhe efikasitetin e shërbimeve të ofruara, do të mbështeten projektet e qeverisjes elektronike, duke siguruar gjithashtu nevojën për koordinim ndër-institucional për të zhvilluar dhe zbatuar politikat për qeverisjen dixhitale. Ngritja e kapaciteteve të administratës publike do të mbështetet përmes zhvillimit të politikave stimuluese për ruajtjen e stafit të specializuar në kuadër të skemave të bashkëpunimit me partnerët e jashtëm.
- **Qeverisja lokale** – për të adresuar sfidat ekzistuese do të bëhet rishikimi funksional i sistemit të vetëqeverisjes lokale dhe do të plotësohet më tutje korniza ligjore e vetëqeverisjes lokale. Gjithashtu, do të iniciohet krijimi i grantit të katërt për komuna të cilat do të përdoret për financimin e projekteve kapitale të komunave, sipas përzgjedhjes së qeverive lokale, për zhvillim të gjithanshëm.

1.3.2. Politika e jashtme dhe integrimi euro-atlantik

- **Politika e jashtme dhe diplomacia** – prioritetet do të fokusohen në fuqizimin e marrëdhënieve diplomatike me partnerët strategjikë, përcaktimin e fushave specifike të bashkëpunimit me vendet që e kanë njohur Republikën e Kosovës, si dhe do të përcaktohen prioritetet për anëtarësim në institucione dhe organizata ndërkombëtare. Për funksionim më efikas do të bëhet rishikimi funksional i shërbimit të jashtëm bazuar në performancë, rezultate dhe në përputhje me interesat strategjike të vendit. Do të mbështetet diplomacia publike, fuqizimi i mekanizmave për promovimin e historisë, traditave dhe kulturës së vendit tonë.
- **Integrimi euro-atlantik** - Qeveria do ta intensifikojë punën në bashkëpunim me partnerët strategjik. Përfshirja në Partneritetin për Paqe, si instrument i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit me NATO-n dhe kontributin e drejtpërdrejtë për paqen dhe sigurinë, është prioritet afatmesëm i Republikës së Kosovës. Anëtarësimi në NATO është qëllim strategjik i Kosovës. Qeveria do të angazhohet për të marrë pjesë aktivisht, me kapacitetet e veta të specializuara ushtarake dhe civile, në mbështetje të paqes, stabilitetit dhe sigurisë kudo nëpër botë.

Agjenda e integritit evropian do të jetë pjesë integrale e agjendës qeveritare. Integrimi evropian do të jetë në sinkron të plotë me axhendën e zhvillimit të gjithmbarshëm të vendit; do të intensifikohen përpjekjet për reforma për të përmbushur obligimet që rrjedhin nga MSA, duke përfshirë edhe procesin e liberalizimit të vizave si një ndër prioritetet e larta të Qeverisë, si dhe obligimet që rrjedhin nga dialogu i vazhdueshëm për bashkërendim të politikave me BE-në.

- **Fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal** - Qeveria synon të ndërtojë marrëdhënie të mira me të gjithë vendet fqinje dhe ato të rajonit. Kosova është e përkushtuar të thellojë më tutje partneritetin strategjik me Shqipërinë, duke siguruar bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e ekonomisë dhe energjetikës, arsimit, artit, kulturës, politikës së jashtme dhe sigurisë, sportit dhe turizmit. Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë përmes dialogut dhe në frymën e parimit të reciprocitetit.
- **Mërgata** - Qeveria do të angazhohet për të rritur rolin e mërgatës në zhvillimin dhe promovimin e vendit nëpërmjet angazhimit direkt të tyre në agjendën zhvillimore; fuqizimin e shkollës shqipe kudo nëpër botë; do të promovojë gjuhën, historinë dhe kulturën kombëtare. Qeveria do të rrisë rolin e mërgatës duke mundësuar përfaqësimin politik të saj në proceset vendimmarrëse në Kosovë. Në mënyrë të veçantë, Qeveria do të punojë në angazhimin konkret të ekspertëve dhe studiuesve nga mërgata, për të mundësuar transferimin e aftësive të tyre dhe forcimin e lidhjeve të tyre me atdheun.

1.3.3. Mbrojtja dhe siguria

Qeveria do t'i trajtojë me prioritet mbrojtjen dhe sigurinë dhe do të rrisë buxhetin për këto fusha. Në këtë drejtim, do të mbështetet rritja e kapaciteteve të institucioneve të vendit për mbrojtje dhe siguri, përmirësohet korniza ligjore, si dhe do të zhvillojë politikën e sigurisë dhe mbrojtjes duke i përcaktuar parimet dhe drejtimit kryesore të Qeverisë në këtë fushë.

- Qeveria e Republikës së Kosovës është e përkushtuar në rritjen e kapaciteteve për mbrojtje dhe siguri, në mënyrë që, në kohë paqeje dhe krize, autoritetet ushtarake dhe civile të bashkëpunojnë në mbrojtjen e interesave të Kosovës.
- Qeveria do të angazhohet që forcat e armatosura të jenë pjesëmarrëse në stërvitjet e përbashkëta ushtarake me shtetet anëtare të NATO-s. Do të vazhdojë mbështetjen për profesionalizimin dhe sigurimin e pajisjeve ushtarake sipas standardeve të NATO-s, duke u bazuar në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit.
- Gjithashtu, Qeveria ka për prioritet ngritjen e profesionalizmit dhe kapaciteteve për mbrojtje nga sulmet eventuale hibride dhe kibernetike që vijnë nga brenda dhe jashtë vendit.

1.3.4. Rendi, ligji dhe siguria publike

Për funksionim të shtetit të së drejtës, zhvillim ekonomik dhe barazisë para ligjit, Qeveria do të trajtojë me prioritet përmirësimin e mëtutjeshëm të kornizës ligjore dhe institucionale, infrastrukturën e nevojshme dhe fuqizimin e kapaciteteve.

- **Rendi dhe siguria publike** - prioritet i Qeverisë është forcimi i kapaciteteve policore për luftimin e të gjitha formave të krimit, shtimit të hetimeve të integruara financiare dhe modernizimit të pajisjeve të policisë. Me theks të veçantë, do të mbështetet forcimi i kapaciteteve për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, trafikimit me njerëz, narkotikëve dhe angazhimi në zbatimin e konceptit për menaxhimin e integruar të kufirit. Mes tjerash, prioritet

i Qeverisë është rishikimi i plotë i kornizës strategjike për rendin dhe sigurinë publike. Do të mbështetet fuqizimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e emergjencave. Gjithashtu, Qeveria do të trajtojë me prioritet politikat e migrimit si nevojë për menaxhimin e migrimit të brendshëm dhe të jashtëm, dhe koordinimin ndërinstitucional në kuadër të Autoritetit Qeveritar për Migrim.

- **Të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe komunitetet** - Qeveria ka prioritet krijimin e mundësive të barabarta dhe jo-diskriminuese, respektimin e të drejtave të njeriut, fuqizimin e mekanizmave për barazi gjinore, mbrojtjen nga dhuna në familje, ndihma juridike falas, kompensimin e viktimave të krimeve të luftës, integrimin e grupeve të marginalizuara dhe lirinë e shprehjes. Gjithashtu, fokus i veçantë do t'i kushtohet krijimit të mekanizmave për identifikimin e krimeve të luftës në Kosovë
- **Rishikimi i sistemit të drejtësisë** - ndër prioritetet tjera në sektorin e drejtësisë është edhe rishikimi i sistemit të drejtësisë, respektivisht hartimi i strategjisë sektoriale. Gjithashtu prioritet është procesi i vetingut, krijimi i Gjykatës Komerciale, fuqizimi i profesioneve të lira, miratimi i Kodit Civil, rregullimi i çështjeve pronësore, rishikimi i legjislacionit penal dhe themelimi i qendrës për evidencën penale.
- **Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit** - është prioritet tjetër kryesor i Qeverisë, i cili do të mbështetet duke rritur kapacitetet e institucioneve, fuqizimin e mekanizmave ekzistues. Në kuadër të llogaridhënies institucionale prioritet i Qeverisë është kompletimi i legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe ngritja e kapaciteteve për trajtimin e rasteve të sinjalizuara.

1.3.5. Çështjet ekonomike

Zhvillimi ekonomik do të bazohet në zhvillimin e ndërmarrësisë në tërësi dhe, me fokus të veçantë, në mbështetjen për ndërmarrjet e vogla, të mesme dhe industritë prodhuese, duke i parë ndërmarrësit si forca kryesore në hapjen e vendeve të reja të punës dhe në zhvillim ekonomik. Modernizimi i infrastrukturës dhe siguri i furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike gjithashtu do të jetë prioritet i lartë në kuadër të periudhës afatmesme, duke përfshirë gjithashtu mbështetjen për sektorin e bujqësisë, avancimin e politikave tregtare dhe turizmit, si dhe politikat e punësimit.

Transporti dhe telekomunikimi

- **Infrastruktura** - në funksion të zhvillimit ekonomik, do të punohet në rishikimin e politikave në sektorin e transportit; rishikimi i dinamikës së projekteve ekzistuese të infrastrukturës rrugore, dhe prioritetizimi i projekteve të reja për zgjerimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore. Do të vazhdohet me rehabilitimin e përgjithshëm dhe modernizimi i Linjës së 10-të hekurudhore; studime të nevojshme për linjën me Shqipërinë dhe mbi rehabilitimin/modernizimin e linjave që lidhin aeroportin me degët e pjesës jugore dhe veriore. Prioritetet tjera janë politikat e aviacionit civil, përkatësisht qasja lidhur me aeroportin e Gjakovës dhe hapësirën ajrore të Kosovës.

- **Përmirësimi i sigurisë dhe mirëmbajtjes rrugore** - Qeveria do të punojë për rritjen e nivelit të sigurisë në trafikun rrugor dhe, gjithashtu, do të përmirësojë planifikimin dhe programimin e punëve për mirëmbajtjen e rrugëve përmes Sistemit Inteligjent të Transportit (SIT).
- **Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit (TIK)** – Qeveria do t'i kushtojë rëndësi të veçantë zhvillimit të teknologjisë informative, nëpërmjet: harmonizimit të kornizës ligjore dhe politikave me legjislacionin e BE-së në fushën e infrastrukturës së teknologjisë informative; shtrirjen e infrastrukturës brezgjere në zona të pambuluara për qasje në internet dhe përkrahjen e shtrirjes së infrastrukturës mobile 5G, duke përfshirë zhvillimin e burimeve njerëzore për ekonominë dixhitale; themelimit të qendrave të teknologjisë me infrastrukturë të qëndrueshme dhe tërheqëse për kompanitë ndërkombëtare dhe vendore; hartimit të politikave stimuluese për mbështetjen e teknologjisë së informimit dhe komunikimit, sidomos në rastin e kompanive të reja (“start-up”) dhe atyre ekzistuese.

Energjia dhe minierat

- **Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike** do të adresohet përmes rehabilitimit të kapaciteteve ekzistuese energjetike; liberalizimit të plotë të tregut të energjisë elektrike i cili kërkon finalizimin e kornizës rregullative dhe integrimin në tregun rajonal; krijimin e një zone të përbashkët energjetike Kosovë - Shqipëri dhe qasja e Kosovës në rrjetet e furnizimit me gaz.
- **Shfrytëzimi racional i burimeve të ripërtërishme të energjisë elektrike** - synohet që të arrihen caqet e dakorduara me komunitetin e energjisë, me qëllim arritjen e pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e ripërtërishme në bruto, me fokus konsumin final të energjisë; rishikimi i skemave mbështetëse për projektet e energjisë së ripërtërishme dhe rikonceptimi i përdorimit të burimeve hidro për prodhimin e energjisë elektrike.
- **Ulja e konsumit të energjisë përmes masave të efijencës** - Qeveria do të vazhdojë të mbështesë investimet në efijencën e energjisë në sektorin publik dhe në zbatimin e rrjeteve të ngrohjes qendrore në qytetet e Kosovës; kompletimin e kornizës ligjore për efijencën e energjisë; funksionalizimin e Fondit dhe rritjen e stimujve në sektorin privat dhe ekonominë familjare.
- **Shfrytëzimi i resurseve minerare** - do të bëhet sipas parimit të zhvillimit të qëndrueshëm duke përmirësuar kornizën ligjore dhe politikave për sektorin mineral; përgatitjen e studimit gjithëpërfshirës për shfrytëzimin e minierave; analizës së fizibilitetit të Trepçës; zhvillimit të industrisë përpunuese (valorizimi i produkteve minerale), dhe nxitja e sektorit privat për zhvillimin e përpunimit të produkteve minerale.

Zhvillimi i balancuar rajonal

- Do të punohet në drejtim të konceptit të zhvillimit të balancuar rajonal, duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të komunave që kanë potencial ekonomik për të siguruar konvergencë ekonomike dhe sociale. Është e nevojshme të ndërmerren masa për të rritur konkurrencën

ndërmjet rajoneve zhvillimore/zonave të ndryshme të Kosovës, në mënyrë që të arrihen nivele më të larta të produktivitetit, punësimit, mirëqenies dhe barazisë. Prioritetet kryesore do të fokusohen në zhvillimin e instrumenteve për të nxitur konkurrencë më të madhe midis rajoneve dhe në adresimin e pabarazisë rajonale në aspektin e zhvillimit socio-ekonomik.

Mbështetja për industrinë dhe biznesin

- **Bujqësia dhe zhvillimi rural** - politikat e Qeverisë në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural do të fokusohen në tri aspekte kryesore: rritjen e produktivitetit përmes avancimit të politikave, investimeve në infrastrukturë dhe inovacionit në bujqësi. Në këtë kuadër do të riorganizohet skema e subvencioneve dhe skema e granteve, bazuar në kritere të qarta dhe transparencë të plotë; gjithashtu do të rishikohen politikat bujqësore, duke zhvilluar Programin e Ri për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

Rregullimi i mëtejshëm i tokave bujqësore dhe mbrojtjes së tyre nga ndërrimi i destinimit të planifikuar, do të jetë një fokus tjetër i Qeverisë. Fermerët do të mbështeten përmes një mekanizmi për sigurime bujqësore, si dhe do të lehtësohet qasja në fonde për bujqit nëpërmjet rritjes së mbulueshmërisë së kredive nga Fondi Kosovar për Garantim të Kredive.

- **Infrastruktura e bujqësisë** - do të mbështetet për të siguruar sistem të qëndrueshëm të ujitjes së tokave bujqësore, gjithashtu duke ndërtuar dhe rehabilituar rrjetin rrugor të zonave rurale.
- **Siguria e ushqimit** - Qeveria synon që të avancojë politikat e sigurisë së ushqimit dhe përafrimin e tyre me standardet e BE-së, me theks të veçantë në sigurimin e kapaciteteve institucionale.
- **Politikat industriale dhe zhvillimi i sektorit privat** - Qeveria do të lehtësojë të bërit biznes dhe do të fuqizojë sektorin privat, në veçanti sa i përket masave stimuluese si pasojë e ndikimit të krizës së pandemisë. Do të mbështetet avancimi i politikave industriale në përgjithësi dhe sigurimi i infrastrukturës së cilësisë, si dhe ngritja e standardeve të prodhimit të industrive të vendit.
- **Zhvillimi i turizmit** – krahas zhvillimit të politikave, më prioritet të lartë do të trajtohen edhe projektet për përmirësimin e infrastrukturës që mundësojnë zhvillimin e turizmit, dhe mbështetjen e rivitalizimit të potencialeve turistike ekzistuese, duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, me theks të veçantë në mbrojtjen e mjedisit dhe përkrahjes së bizneseve në zhvillimin e turizmit rural, si dhe mbështetjen e zhvillimit të produkteve turistike në zonat e trashëgimisë kulturore.
- **Nxitja, promovimi dhe përkrahja e investimeve të huaja** - do të adresohet duke eliminuar pengesat për investimet e huaja; duke bërë përmirësimin e kornizës institucionale për të mundësuar përmbushje efikase të përgjegjësisë dhe zbatimin e prioritetëve; përgatitjes dhe fillimit të zbatimit të shërbimeve dhe programeve të kujdesit pasues për investitorët, dhe përmirësimin e infrastrukturës së nevojshme për investitorët.

- **Politikat tregtare** – në kuadër të këtyre politikave, prioritetet është angazhimi i zbatimit të obligimeve në kuadër të bashkëpunimit rajonal, përmirësimit të legjislacionit, ngritjen e cilësisë së produkteve, mbrojtjen e konsumatorit, dhe pronësisë intelektuale, si dhe fushat relevante që rezultojnë në rritjen e prodhimit, përmirësimin e bilancit tregtar, inovacionit dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës në përgjithësi. Prioritet do t'i kushtohet edhe zhvillimit të procedurave për anëtarësim në organizata rajonale dhe ndërkombëtare, negocimit të marrëveshjeve tregtare me vendet rajonale dhe vendet tjera.

Hulumtimi, zhvillimi dhe inovacioni

- Qeveria e Kosovës synon që të rris mbështetjen për fushën e hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit duke fuqizuar ekosistemin inovativ të vendit, si dhe duke bërë ndërlidhjen e hulumtimit, zhvillimit dhe inovacionit me sektorin privat si motor i krijimit të vendeve të reja të punës. Kjo synohet të arrihet nëpërmjet: plotësimit dhe harmonizimit të kornizës legjislative, institucionale dhe të politikave për kërkim, inovacion dhe teknologji informative me atë të BE-së, si dhe kompletimin e procesit të specializimit të mençur; dhe hartimin e politikave stimuluese për mbështetjen e teknologjisë së informimit dhe komunikimit.

Tregu i punës dhe punësimi

- Qeveria synon të adresojë nivelin e lartë të papunësisë te gratë, të rinjtë dhe të rejat, grupet e cenuara, si dhe do të fokusohet në përmirësimin e të drejtave të punëtorëve dhe garantimin e standardeve minimale për sigurinë dhe shëndetin në punë. Me theks të veçantë, gjithashtu, synojmë që, duke u mbështetur në sistemin dual të arsimit, të punësohen edhe studentët nëpërmjet praktikave institucionale të paguara dhe kontraktimit të punës me kohë të pjesshme. Këto do të arrihen nëpërmjet: rishikimit të Planit për Punësimin e të Rinjve; përmirësimin e kornizës ligjore, rregullative dhe të politikave; promovimit të lidhjes së arsimit profesional me nevojat e tregut; forcimit të kapaciteteve të shërbimeve publike të punësimit dhe zgjerimit të masave aktive të tregut të punës; mbështetjes më të madhe të rinisë dhe grave në fushën e zhvillimit të ndërmarrësisë dhe subvencionim të pagave në sektorin privat.

1.3.6. Mjedis

Gjendja e mjedisit në Kosovë ka nevojë për përmirësim të madh dhe të vazhdueshëm. Qeveria do t'i fokusojë politikat e saj në përmirësimin e cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës; do të përmirësojë dhe rrisë nivelin e menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave, shfrytëzimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjes së biodiversitetit dhe peizazheve natyrore. Të gjitha këto do të bëhen në harmoni të plotë me shfrytëzimin sa më racional të burimeve natyrore ë, nëpërmjet balancës së nevojave ekonomike dhe qëndrueshmërisë mjedisore.

- **Avancimi i ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit** - Qeveria e Kosovës do të bëjë rishikimin dhe zbatimin e politikave për përmirësimin e cilësisë së ajrit; ruajtjen e biodiversitetit; mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit. Menaxhimi i integruar i mbeturinave do të promovohet duke u bazuar gjithashtu në mbështetjen e partnerëve zhvillimorë. Në anën tjetër, do të bëhet fuqizimi i kornizës ligjore në fushën e menaxhimit të mbeturinave; kimikate;

vlerësimin e ndikimit në mjedis; parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes; mbeturinat nga industria e nxjerrjes së mineraleve; si dhe mbrojtja e ë natyrës, do të trajtohet me prioritet.

- **Avancimi i menaxhimit të ujërave dhe ngritja e infrastrukturës** – zbatimi i Strategjisë së Ujërave do të orientohej përmes planit operacional, ku do të të adresohen sfidat kryesore në menaxhimin e ujërave, duke përfshirë këtu qasjen shtetërore sa i përket akumulimit të ujërave, hidrosistemet e reja, dhe infrastrukturës mbrojtëse përgjatë lumenjve.
- **Zhvillimi i politikave për avancimin e planifikimit hapësinor** – sa i përket zhvillimit dhe avancimit të planifikimit hapësinor, Qeveria planifikon përfundimin dhe miratimin e Hartës Zonale të Kosovës; rishikimin e Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri"; Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"; si dhe funksionalizimin dhe avancimin e sistemit SPAK për nevojat e MMPH-së.

1.3.7. Shëndetësia

Fokusi i Qeverisë do të jetë në sigurimin dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve, avancimin e cilësisë, sigurisë, efektshmërisë, ofrimit të shërbimeve shëndetësore, riorganizimit të sektorit shëndetësor dhe financimit të qëndrueshëm të tij. Qeveria synon t'i arrijë këto objektiva nëpërmjet hartimit të politikave adekuate, kompletimit të kornizës legjislative, fuqizimin e shërbimeve të edukimit dhe preventivës, promovimit, ngritjes dhe avancimit të burimeve njerëzore/profesionale, rritjes së buxhetit në shëndetësi, modernizimit të institucioneve shëndetësore dhe sigurimit të pajisjeve adekuate mjekësore. Për më tepër, do të fuqizohet kujdesi shëndetësor i integruar, i përqendruar në pacientë, përmes zbatimit të mjekësisë së mbështetur në të dhëna dhe funksionalizimit të sistemit informativ shëndetësor, si parakusht për jetësimin e Sigurimit Shëndetësor. Me qëllim të adresimit të mangësive të sistemit shëndetësorë, prioritetet e Qeverisë për tre vitet e ardhshme do të fokusohen si në vazhdim:

- **Riorganizimi i sektorit shëndetësor dhe ofrimi i shërbimeve cilësore shëndetësore** - rishikimi i Strategjisë Sektoriale të Shëndetësisë; plotësimi dhe ndryshimi i legjislacionit bazik në sektorin e shëndetësisë; vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave për kujdesin paliativ; rrjetëzimi i mjekëve kosovarë në mërgatë dhe ndërlidhja me organizatat dhe odat e profesionistëve shëndetësorë përmes programeve të shkëmbimit të profesionistëve; planifikimi afat-gjatë i resurseve humane në sektorin e shëndetësisë.
- **Sigurimi i financimit të qëndrueshëm shëndetësor** - ky prioritet ka për qëllim krijimin dhe zbatimin e fondit të sigurimeve shëndetësore; plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit për sigurim shëndetësor; miratimin e i legjislacionit dytësor për përcaktimin e kritereve për lirimin nga pagesa e kontributit për sigurim shëndetësor; rishikimin e listës së barnave esenciale; vlerësimin e zbatimit të politikave të shëndetësisë (ex-post).

1.3.8. Rinia, kultura dhe sporti

Në kuadër të politikave afatmesme, Qeveria do të mbështesë zhvillimin dhe promovimin e veprave të artit dhe kulturës, do të investojë në infrastrukturën e nevojshme për kulturë, duke përfshirë gjithashtu zhvillimin dhe promovimin e sportit dhe politikave për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore. Me qëllim të adresimit të nevojave në këtë sektorë, Qeveria do të mbështesë këto prioritetë:

- **Përmirësimin e infrastrukturës** – me synim të promovimit të zhvillimit të veprave të artit dhe kulturës, Qeveria do të mbështesë përmirësimin e infrastrukturës kulturore duke investuar në ndërtimin e objekteve të reja për Teatrin e Operës dhe Baletit, Sallën Kulturore, dhe renovimin e atyre ekzistuese, sipas nevojës.
- **Mbështetja financiare për artin dhe kulturën** - Qeveria do të transformojë sistemin e planifikimit dhe shpërndarjen e financimit për artin dhe kulturën, do të rrisë subvencionimin për artistët e pavarur dhe ngjarjet artistike dhe kulturore, si dhe do t'u ofrojë artistëve kushte adekuate për punë.
- **Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore** – me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore, do të mbështetet krijimi i mekanizmave për hulumtime në fushën e trashëgimisë, për financimin e kuadrove deficitare në fushën e trashëgimisë dhe për restaurim të objekteve të trashëgimisë kulturore. Qeveria do të bëjë dixhitalizimin e materialeve të arkivave shtetërore e materialeve arkeologjike, dixhitalizimit të trashëgimisë kulturore, do të krijohet korniza ligjore për kthimin e objekteve të trashëgimisë të marra në mënyrë të jashtëligjshme, si dhe do të bëhet identifikimi i lokaliteteve të reja arkeologjike për të cilat nuk ka pasur vëmendje institucionale.

Rinia

- Qeveria do të angazhohet për ndërveprim institucional për të gjitha çështjet që ndërlidhen me rininë. Do të mbështetet zhvillimi i politikave rinore, të fokusuara në qytetarinë aktive; përgatitjen për tregun e punës; do të rrisë buxhetin për rininë dhe do ta orientojë atë në aktivitetet që nxisin inovacionin, ndërmarrësinë dhe vetëpunësimin.

Sporti

- **Modernizimi i infrastrukturës sportive** – me prioritet do të mbështetet promovimi i sportit në përgjithësi, dhe do të investohet në modernizimin e infrastrukturës sportive, duke përfshirë Qendrën Kombëtare të Sportit, ndërtimin e stadiumeve rajonale sipas standardeve të UEFA-së dhe fusha të tjera sportive.
- **Mbështetja për edukimin sportiv** - Qeveria do të financojë projektet e qendrave multifunksionale sportive, si dhe një program intensiv për të mbështetur financiarisht sportin shkollor, me theks edukimin sportiv të moshave të reja. Qeveria do t'u jap mbështetje financiare dhe administrative klubeve me garues në garat ndërkombëtare, përfshirë klubet dhe sportet individuale që gjithashtu merren me programin e edukimit sportiv, do të mbështetet sporti shkollor dhe sporti universitar; do të krijohen klube të reja të femrave si dhe përkrahje të klubeve cilësore të cilat kanë mundësi të aktivizimit në liga ndërkombëtare.

1.3.9. Arsimi dhe shkenca

Qeveria në tri vitet e ardhshme do të fokusohet në rritjen e cilësisë në arsim në të gjitha nivelet në mënyrë që sistemi ynë arsimor të përgatisë nxënës dhe studentë të aftë për jetë dhe të plotësojë nevojat e tregut të punës. Gjithashtu, rol më i madh do t'i kushtohet edhe shkencës duke fuqizuar mekanizmat dhe kornizën përkatëse të politikave. Në këtë drejtim, synohet që Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë të rishikohet dhe miratohet me kohë. Prandaj, me qëllim të adresimit të nevojave dhe reformave të sistemit arsimor, prioritetet e Qeverisë për tre vitet e ardhshme do të fokusohen si në vazhdim në:

- ***Edukimin në fëmijërinë e hershme*** – rritja e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor të moshës 0-5 vjeç nëpërmjet: zgjerimit të rrjetit të institucioneve në edukimin parafillor dhe parashkollor në tërë vendin; rregullimin e mënyrës së financimit; licencimit dhe rilicencimit të institucioneve parashkollore publike dhe private; miratimit të Ligjit për Edukim në Fëmijërinë e Hershme; miratimit dhe zbatimit të kurrikulës për edukimin në fëmijërinë e hershme, trajnimin e edukatorëve; rritjes së identifikimit dhe përfshirjes në këtë nivel për fëmijët me nevoja të veçanta si dhe rritjen e numrit të asistentëve për këtë kategori; rritjes së përfshirjes së fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në institucionet parashkollore.
- ***Rritjen e cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm*** – synohet të arrihet nëpërmjet: përmirësimit të infrastrukturës dhe vendosjes së infrastrukturës arsimore në shërbim të komunitetit; rishikimit të kornizës legislative në këtë nivel arsimor; vlerësimit të kurrikulave arsimore; fuqizimit të vendimmarrjes me bazë në shkollë, me përfshirje më të madhe të komunitetit dhe forcimi i marrëdhënies prind-mësimdhënës-nxënës; hartimit të ligjit për tekstet mësimore dhe rishikimit të Këshillit për tekstet mësimore; plotësimit të kabineteve me pajisjet më të reja teknologjike dhe dixhitalizimit të përmbajtjeve arsimore; futjes së lëndës së kodimit në ciklin e ulët fillor; ngritjes së kapaciteteve të ekipeve vlerësuese pedagogjike në komuna; ngritjes profesionale të inspektorëve të arsimit për vlerësimin e performancës.
- ***Rritjen e cilësisë së arsimit dhe aftësimit profesional*** – ky prioritet synohet të përmbushet duke rritur bashkëpunimin ndërmjet shkollave profesionale dhe komunitetit të biznesit; vlerësimit dhe miratimit të Kornizës së Kurrikulës për tërë sistemin e AAP-së dhe ndërlidhjen më të fuqishme të kurrikulave të AAP-së me fushat deficitare kombëtare dhe tregun e punës; modernizimin e shkollave profesionale të mesme me pajisje dhe tekste mësimore adekuate; trajnimin e mësimdhënësve për fushën e AAP-së; rishikimit të formulës së financimit dhe përcaktimit të kriterëve të financimit për AAP; themelimit të zyrës për bashkëpunim me sektorin privat, në bashkëpunim me ministrinë përkatëse; krijimit dhe funksionalizimit të platformës dixhitale, për t'u ndërlidhur me kërkesat e tregut të punës në fushën e TIK-ut; fuqizimit të arsimit përgjatë gjithë jetës si dhe stimujt për përfshirjen e të rinjve në punë profesionale, në bashkëpunim me sektorin privat.
- ***Cilësi dhe menaxhim më i mirë në arsimin e lartë*** – kjo synohet të arrihet duke rishikuar dhe miratuar Ligjin për Arsimin e Lartë; finalizimin e Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Akreditim dhe sigurimi i autonomisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim dhe kapaciteteve

profesionale të saj; riorganizimin e universiteteve publike; përpilimin dhe miratimin e udhëzuesit nga Këshilli Shtetëror i Cilësisë për vendosjen e kritereve të monitorimit të IAL-ve; rishikimin dhe miratimin e standardeve të reja për vlerësimin e programeve të nivelit të doktoratave; ridefinimin e formulës së financimit në arsimin e lartë; fuqizimin e pjesëmarrjes në programet rajonale dhe ndërkombëtare të mobilitetit akademik, përfshi mësimdhënësit, studentët dhe hulumtuesit brenda dhe jashtë vendit; krijimin e “Fondit të bursave për shkollim dhe stimulim të studentëve të dalluar dhe kuadrove deficitare”.

- **Shkenca** – do të rritet fokusimi dhe investimi në shkencë duke funksionalizuar Këshillin Kombëtar të Shkencës dhe krijimin e Fondit Kombëtar të Shkencës, Inovacionit dhe Ekselencës; rritjen e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë; krijimit të programeve të veçanta për të angazhuar kapacitetet e mërgatës si fuqi e kualifikuar, në fushën e hulumtimeve shkencore; dhe mbështetjes së projekteve shkencore me rëndësi për arritjen e prioritetëve kombëtare.

1.3.10. Mbrojtja sociale

Përmirësimi i sistemit të mbrojtjes sociale në Kosovë, Qeveria konsideron se mund të arrihet me anë të ndërmarrjes së masave për ulje të varfërisë, përfshirjes së grupeve të marginalizuara në jetën socio-ekonomike të vendit si dhe nëpërmjet sistemit të rishpërndarjes së të mirave publike. Në fushën e shërbimeve sociale, planifikohet të sigurohet një sistem i qëndrueshëm për financimin e shërbimeve sociale dhe zbatimin në vazhdimësi të skemave dhe përfitimeve të pensioneve, si dhe, aty ku është e nevojshme - reformimin e politikave aktuale sociale, reformimin e sistemit të pensioneve në aspektin legjislativ, organizativ dhe të bashkëpunimit ndërkombëtar.

- **Rritja e mirëqenies përmes ristrukturimit të shërbimeve sociale** - ky prioritet ka për synim plotësimin dhe ndryshimin e kornizës ligjore në fushën e shërbimeve sociale; rritjen e nivelit të punësimit për grupet e marginalizuara; fuqizimin e mekanizmave të financimit dhe decentralizimit të shërbimeve sociale, përmes krijimit të Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale; licencimit dhe ngritjes së kapaciteteve të ofruesve individual, punëtorëve social, ofruesve publik dhe joqeveritar në fushën e shërbimeve sociale dhe familjare.

Po ashtu, ky prioritet përfshin edhe synimet e Qeverisë për përmirësimin dhe ngritjen e infrastrukturës së qendrave strehuese dhe qendrave me bazë në komunitet për ofrimin e shërbimeve për personat e moshuar dhe me aftësi të kufizuara; mbështetja e familjeve në nevojë, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, personave të moshuar, viktimave të dhunës në familje, përmes qendrave strehuese, qendrave me bazë në komunitet dhe OJQ-ve të licencuara.

- **Reformimi i skemave pensionale dhe benifiteve** - në kuadër të këtij prioriteti Qeveria do të bëjë hartimin e politikave të reja për Skemën e Ndihmës Sociale, Shtesat e Fëmijëve dhe Kthimeve Tatimore; plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit primar dhe sekondar për përfitimet e personave me aftësi të kufizuara; dhe zhvillimin e marrëveshjeve ndërkombëtare për çështjet e pensioneve.

PJESA E DYTË

2. KORNIZA MAKRO-FISKALE

Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021-2023 është ndërtuar mbi një skenar makroekonomik që parasheh rimëkëmbje të rritjes ekonomike në vend nga kriza e krijuar nga pandemia COVID-19 në 2020-ën, për t'u ndjekur nga një tendencë normalizimi drej niveleve historike në dy vitet e tjera pasardhëse.

Rritja ekonomike mbështetet në një kombinim të rritjes së kërkesës së brendshme dhe asaj të jashtme. Megjithatë, ekzistojnë shumë pasiguri dhe rreziqe të zhvendosura në kahun e poshtëm gjatë periudhës afatmesme, të cilat më së shumti ndërlidhen me kohëzgjatjen dhe magnitudën e situatës aktuale të pandemisë dhe të masave apo politikave të ndërmarra nga autoritetet përkatëse për të luftuar këtë situatë.

Qeveria e Republikës së Kosovës është në vazhdimësi e orientuar drejt stabilitetit makro – fiskal dhe synon që në periudhën afatmesme (2021-2023) të mbajë një nivel të deficitit buxhetor brenda rregullave fiskale dhe të sigurojë rezerva të mjaftueshme buxhetore dhe shmangie të akumulimit të tepruar të borxhit publik. Një mjedis i tillë, i qëndrueshëm makro-fiskal, favorizon rritjen ekonomike që vjen kryesisht si rezultat i aktivitetit të sektorit privat.

Dokumenti i KASH-it në vazhdimësi është bazuar në ruajtjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të kornizës fiskale të bazuar në rregulla fiskale shumë të rëndësishme, duke përfshirë rregulla që kërkojnë: *i)* Rishikime buxhetore me ndikim neutral në deficit; *ii)* Kufizim të deficitit buxhetor në 2% të BPV-së; *iii)* Kufizim të rritjes së faturës së pagave dhe mëditjeve me rritjen e BPV-së nominale; *iv)* Kufizim të borxhit prej 40% të BPV-së, gjegjësisht 30% për përjashtimin e investimeve kapitale nga rregulla e deficitit, sipas “klauzolës së investimeve”. Përjashtimi nga kufizimi i deficitit për projektet kapitale të financuara nëpërmjet huadhënies afatgjate dhe koncesionare të donatorëve, ofron hapësirë të mjaftueshme për të trajtuar nevojat për investime kapitale brenda një kornize të kujdesshme dhe të shëndoshë fiskale.

Në këtë kontekst strategjik, objektivat fiskale afatmesme të Qeverisë mbështeten në parimet si më poshtë:

- Të mbajë lartë nivelin e **investimeve kapitale** për të adresuar pengesat strukturore dhe për të rritur konkurrencën përmes **përmirësimit të infrastrukturës publike**;
- Racionalizimi i shpenzimeve operative dhe krijimi i hapësirës për rritjen e financimit dhe efektivitetit të institucioneve **gjyqësore, shëndetësore dhe arsimore**;
- **Përmirësimi i efektivitetit të shpenzimeve sociale dhe subvencioneve bujqësore** përmes targetimit më të mirë;
- **Mobilizimi i të hyrave** duke zgjeruar bazën tatimore;
- **Thjeshtëzimi i tarifave administrative dhe zvogëlimi i barrës rregullative.**

2.1. KORNIZA MAKROEKONOMIKE

2.1.1 Ambieni i jashtëm ekonomik

Me fillimin e vitit 2020, problemet tregtare mes SHBA-së dhe Kinës që çuan në dhe rënien e sektorit të prodhimit në nivel global apo edhe paqartësitë me efektet e Brexit u zëvendësuan me pandeminë COVID-19. Duke huazuar shprehjen e FMN-së, kriza që COVID-19 vazhdon të shkaktojë në nivel global quhet Izolimi i Madh. Ky term vjen si krahasim ndaj Depresionit të Madh, duke qenë se kriza që po e kalojmë tani është më e rënda prej periudhës së Depresionit të Madh. Ndryshe nga kriza globale financiare e vitit 2008, që për Kosovën efektet e saj ishin të neglizhueshme, kjo krizë prek Kosovën si çdo vend tjetër në botë. Jo vetëm që kjo krizë e ndikon direkt ekonominë e Kosovës, mirëpo ndikon edhe kanalet përmes të cilave mjedisi i jashtëm ekonomik e ndikon Kosovën: tregtia, remitencat dhe investimet e huaja dhe eventualisht sektori financiar.

Kryefjala e kësaj krize është pasiguria, apo thënë ndryshe paqartësia. Fillimisht kjo krizë filloi si një goditje ndaj ofertës (me mbylljen e shumë industrive), mirëpo si rezultat i së parës dhe pasigurisë për të ardhmen është goditur edhe kërkesa. Deri më tani ekzistojnë dy faza për t'u përballur me këtë krizë: faza e kontrollimit dhe e stabilizimit të numrit të rasteve të infektuara me COVID-19, dhe faza e rimëkëmbjes. Paqartësitë kyçe në këtë krizë janë: kohëzgjatja e karantinimit të përgjithshëm (si fazë fillestare e trajtimit të krizës apo vala e parë (ndoshta e vetme) e rasteve me COVID-19), dhe kohëzgjatja e përgjithshme e pandemisë (deri në gjetjen e vaksinës). Karakteristika kryesore e kësaj krizë është fakti se shpesh interesi i rimëkëmbjes apo mbështetjes së ekonomisë bie ndesh me interesin e ruajtjes së shëndetit publik. Karakteristika tjetër, në krahasim me krizën e fundit të këtyre përmasave, atë të Depresionit të Madh, është prezenca dhe ndihma e institucioneve financiare ndërkombëtare, që supozohet që do të minimizojnë apo edhe eliminojnë politikat proteksioniste të shteteve si në vitet 1930, të cilat si qëllim kishin të ruanin apo përmirësonin bilancin tregtar (dhe llogarinë rrjedhëse) në mungesë të mbështetjes multilaterale financiare që tashmë e ofrojnë shumë institucione sikurse FMN apo Banka Botërore ndër të tjera.

Përkundër paqartësive për të ardhmen, FMN-ja, megjithatë ka projektuar një rënie të BPV-së globale prej 3 përqind në terma realë, përkatësisht: 6.1 përqind dhe 1.0 përqind për ekonominë e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Tregues që mbështetin këtë rënie globale janë: rritja e kërkesave për beneficione të të papunëve në SHBA – 6.6 milionë në javën e fundit të marsit, krahasuar me 280,000 në javën e dytë të marsit; parashikimet për një normë papunësie rreth në SHBA gjatë prillit (Bloomberg, 2020)¹; rënia e prodhimit industrial prej 13.5 përqind; dhe rënia e shitjeve me pakicë prej 20.5 përqind në janar dhe shkurt krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (Bloomberg, 2020)². Gjithashtu, me të dhënat më të fundit (mars 2020), vërehet që indeksi i çmimeve të mallrave bazë ('commodities') ka rënë për 25.6 pikë (si rezultat i tkurrjes së kërkesës dhe rënies së çmimit të naftës), krahasuar me janar 2020. Vlen të ceket se nëse krahasohet çmimi

¹ Worst-Case Fears of 20%-Plus U.S. Jobless Rate Are Now Realistic: <https://www.bloomberg.com/news/articles/2020-04-14/worst-case-fears-of-20-30-u-s-jobless-rate-are-now-realistic>


² China's Economy Suffers Historic Slump Due to Virus Shutdown: <https://www.bloomberg.com/news/articles/2020-03-16/china-manufacturing-and-retail-contract-for-first-time-on-virus>

i naftës (brent), ai ka rënë për gati 50 përqind në mars 2020, krahasuar me dhjetor 2019, apo për gati 33 dollarë/fuçi. Inflacionit, në ekonomitë e zhvilluara pritet të jetë 0.5% gjatë 2020 (gjatë 2019 ishte 1.4), dhe 1.5% gjatë 2021. Në anën tjetër, në ekonomitë në zhvillim, inflacioni pritet të shënojë rënie nga 5.0% në 2019 në 4.6% dhe 4.5% gjatë 2020 dhe 2021, përkatësisht.

Përkundër problemeve të shkaktuara nga kriza e Izolimit të Madh në 2020, gjatë 2021-ës pritet një përmirësim me një rritje globale të BPV-së përmbi trendin historik – 5.8 përqind. Mirëpo, vlen të ceket se përkundër rritjes ekonomike të parashikuar për 2021, për shumë vende kjo nuk do jetë e mjaftueshme për t'u rikthyer në nivelin e zhvillimit ekonomik para krizës.

Duke qenë se kanalet e ndikimit të ekonomive të jashtme në ekonominë e Kosovës janë më të theksuara në relacion me shtetet në Evropë, vlen që kjo (apo këto) ekonomi të analizohen më tutje. Eurozona pritet që gjatë 2020 të pësojë rënie ekonomike prej 7.5 përqind, ndërsa gjatë 2021 pritet një përmirësim me një rritje ekonomike prej 4.7 përqind. Disa nga vendet më të goditura janë Greqia (rënie ekonomike prej 10 përqind) dhe Italia (rënie ekonomike prej 9.1 përqind). Tutje, vendet si Gjermania dhe Zvicra, dy vende prej nga vijnë mbi 60 përqind e remitancave në Kosovë, pritet të kenë rënie ekonomike në 2020 prej 7 dhe 6 përqind, përkatësisht.

Grafiku 1 Rritja ekonomike reale në vendet e tjera



Duke marrë parasysh të dhënat e paraqitura si rezultat i COVID-19 në mjedisin e jashtëm ekonomik dhe kanalet e ndikimit të këtij mjedisi në Kosovë, kjo krizë mund të ndikojë ekonominë e Kosovës në disa aspekte. Sa i përket kanalit të tregtisë, duke qenë se kjo krizë ka shkaktuar një ç'akordim të zinxhirit furnizues global, pritet që gjatë vitit 2020 importi i makinerive, veglave apo pajisjeve elektrive në Kosovë të ndikohet negativisht, duke qenë se afër 30 përqind e këtyre mallrave importohen nga Kina dhe që njëkohësisht përbëjnë një prej komponentëve kryesorë të investimeve private. Poashtu, duke pasur parasysh rënien e çmimeve të mallrave bazë, dhe specifikisht të nikelit (më shumë se 35% të eksporteve të Kosovës janë brenda kategorisë ekonomike të 'Metaleve bazë dhe artikujve prej tyre' – kategori e cila dominohet nga eksporti i nikelit) nga mesatarisht 15,349 dollarë/ton në tremujorin e fundit të 2019 në 11,846 dollarë/ton në mars 2020, eksportet e Kosovës priten të ndikohen negativisht. Gjithashtu, mbyllja e kufijve shkakton vështirësi në zhvillimin e tregtisë në shërbime (veçanërisht transporti dhe udhëtimi). Sa

i përket kanalit të remitancave, siç edhe u cek më lartë, Gjermania, Zvicra dhe Italia (prej nga vijnë mbi 65 përqind e dërgesave të emigrantëve) do të kenë rënie ekonomike gjatë 2020, e cila më tej do të përkthehet në rënie të remitancave drejt Kosovës. Duke marrë parasysh pasigurinë që buron nga kriza e krijuar së fundi si dhe problemeve ekzistuese dhe potenciale në sistemet financiare, edhe kanal i investimeve të huaja do të ndikohet negativisht. Së fundi, në rast të problemeve në sistemet financiare të vendeve prej nga vijnë institucionet e huaja financiare në Kosovë, kjo mund të ndikojë negativisht edhe sistemin tonë financiar.

2.1.2. Zhvillimet e Fundit Ekonomike në Kosovë

Sipas të dhënave preliminare tremujore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale gjatë vitit 2019 është rritur me 4.2% krahasuar me vitin paraprak.

Megjithatë, treguesit indirektë ekonomikë tregojnë se viti 2019 ka qenë vit i një aktiviteti ekonomik më të ngadalësuar se sa të dhënat preliminare të ASK-së. Rrjedhimisht, MFT ka vlerësuar se rritja reale në 2019 të jetë 4.0% në linjë me ecurinë e këtyre treguesve. Në këtë linjë, pritjet që rishikimi i të dhënave nga ASK në publikimin vjetor të BPV-së të reflektojë këto pritje.


Sipas të dhënave preliminare për 2019, **Konsumi** vlerësohet të ketë pasur një rritje prej 2.3% në terma realë, si rezultat i rritjes së konsumit privat me 2.1% dhe atij publik me 3.6%. Rritja më e ngadalësuar në konsumin privat reflekton rënien në kreditë e reja për konsum për rreth 4.1 % dhe rritjen më të ngadaltë në pranimet nga kompensimi i punëtorëve me 6.8% (nga 11% sa ishte në 2018-ën). **Investimet** gjatë 2019-ës janë rritur për 5.7% në terma realë, që reflekton një ngadalësim krahasur me vitin 2018. Kjo rritje mbështet edhe nga një rritje më e ngadalësuar në importin e mallrave kapitale prej vetëm 3.7% dhe një ngadalësimi të dukshëm në investimet publike të cilat kishin një rritje prej vetëm 0.1% si rrjedhojë e aprovimit më të vonshëm të buxhetit 2019 dhe dorëheqjen e qeverisë në gjysmën e dytë të vitit. Në të njëjtën kohë në vitin 2019 investimet e huaja direkte shënuan rënie vjetore prej 2.1%. Ky zhvillim erdhi kryesisht nga mos ri-investimi i fitimit të ri në tremujorin e fundit (kryesisht në sektorin e ndërtimit). **Eksportet neto** gjatë 2019-ës kishin një kontribut pozitiv në rritjen reale prej 0.3% si rrjedhojë e ngadalësimit në importet e mallrave dhe një rritje më të theksuar në eksportet totale.

Inflacioni i matur me ndryshimet vjetore në indeksin e çmimeve të konsumit, është rritur mesatarisht me 2.7% në vitin 2019, me një rritje të theksuar në fillimin e vitit. Ky niveli i çmimeve të konsumit gjatë vitit 2019 i atribuohet kryesisht rritjes së çmimeve të kategorisë së “Ushqimit dhe Pijeve Jo-alkoolike” dhe kategoria e ‘Pije Jo-Alkoolike dhe Duhan’. Ndërsa, kategoria e “Transportit” edhe pse ka shënuar një kontribut pozitiv në inflacion, qëndron më poshtë se niveli i shënuar gjatë vitit 2018, duke qenë në linjë me zhvillimet e çmimit të naftës në tregjet ndërkombëtare.

Bilanci i llogarisë rrjedhëse gjatë vitit 2019³ vlerësohet të jetë -5.8% e BPV-së, kurse deficitit tregtar i mallrave dhe shërbimeve rreth 27.0% e BPV-së. Këto zhvillime paraqesin një përmirësim të lehtë në krahasim me vitin e kaluar.

Eksporti i mallrave dhe shërbimeve shënoi një rritje vjetore prej 6.8%. Eksporti i mallrave ishte për 4.4% më i lartë, ndërsa eksporti i shërbimeve shënoi një rritje prej 7.3%. Eksportet e mallrave drejt vendeve të CEFTA përbëjnë 43%, ndërsa eksportet drejt vendeve anëtare të BE-së përbëjnë 36.1% të të gjitha eksporteve. Ndërsa, nga eksportet drejt vendeve tjera përveq BE dhe CEFTA, pjesëmarrje më të madhe kishin ato drejt Indisë me 8.6% dhe drejt Zvicrës 7.4%. Diversifikimi i eksporteve⁴ është një mënyrë e mirë për të siguruar qëndrueshmërinë e eksporteve, duke kontribuar kështu në përmirësimin e bilancit tregtar të vendit. Struktura e eksportit të Kosovës aktualisht ende është e përqendruar në eksportin e metaleve bazë, të cilat përbëjnë 35% të të gjitha eksporteve të mallrave. Megjithatë, siç mund të shihet në Figurën 2, përqendrimi i strukturës së eksporteve po zvogëlohet gradualisht. Sektorë të rëndësishëm me një rritje të qëndrueshme gjatë dy viteve të fundit janë sektori i plastikës dhe gomës si dhe sektori i ushqimeve të përgatitura, të cilat përbëjnë rreth 13.25% dhe 10.4% respektivisht.

Grafiku 2 Diversifikimi i eksporteve




Importi i mallrave dhe shërbimeve shënoi një rritje vjetore prej 4.3%, ku importi i mallrave shënoi rritje për 3.8% ndërsa importi i shërbimeve shënoi rritje prej 6.2%. Importi i mallrave nga vendet e BE-së përbën rreth 50% të importeve totale, ku më shumë së gjysma dominohet nga Gjermania. Ndërsa, importet nga vendet anëtare të CEFTA përbëjnë rreth 14.4% të totalit të importeve, ato nga Turqia 12.3% dhe ato nga Kina 9.7%.

Bilanci i mallrave gjatë vitit 2019 shënoi rritje vjetore prej 3.7%, ndërsa bilanci i shërbimeve gjatë vitit 2019, është rritur për 8.3%. Shërbimet e udhëtimit vazhdojnë të dominojnë me një pjesëmarrje prej rreth 78.8% të totalit të shërbimeve të eksportuara dhe rreth 43.7% të totalit të shërbimeve të importuara.

³ Vlera e BPV-së për vitin 2019 sipas të dhënave preliminare tremujore të ASK-së.

⁴ Për të paraqitur diversifikimin e eksporteve është përdorur indeksi Herfindal Hirschman sipas katër dimensioneve të ndryshme për eksportin e mallrave dhe eksportin e shërbimeve.


Grafiku 3 Bilanci i llogarisë rrjedhëse



Bilanci i të ardhurave parësore shënoi një rritje vjetore prej 31.7% të shtyra kryesisht nga të kategoria e kompensimit të punëtorëve (kontribut prej 7.7 p.p. dhe rritje prej 8.5%) dhe nga të ardhurat nga investimet (kontribut prej 15.4 p.p.dhe rritje prej 14.3%). **Bilanci nga të ardhurat dytësore** kishte një rritje vjetore prej 7.5%. Rol të rëndësishëm në këtë rritje kishin neto remitencat të cilat shënuan rritje prej 8.1% dhe kishin një kontribut pozitiv prej 6.6 p.p..


Të dhënat e fundit të **tregut të punës** tregojnë se shkalla e punësimit në fund të vitit 2019 ishte 30.1%, duke shënuar një përmirësim prej 1.3 p.p. krahasuar me vitin 2018. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore ka shënuar rënie të lehtë në 40.5% nga 40.9% sa ishte në vitin 2018. Si rezultat, shkalla e papunësisë u zvogëlua me 3.9 p.p. në terma vjetorë duke arritur në 25.7%. Duhet të theksohet se në vitin 2019 Kosova kishte zgjedhje parlamentare, kështu që të dhënat e tregut të punës për vitin 2019 duhet të analizohen duke i'u referuar edhe këtyre zhvillimeve.

Grafiku 4 Tregu i punës



Punësimi sipas nivelit arsimor gjatë vitit 2019 ka pësuar ndryshime. Punësimi me arsim të mesëm profesional dhe ai me arsim terciar është rritur ndërsa punësimi me shkollë të mesme-gjimnaz është ulur. Struktura e punësimit sipas aktiviteteve mbetet pothuajse e njëjtë me vitet e kaluara ku prinë punësimi në aktivitetet e tregtisë, ndërtimtarisë, prodhimit dhe arsimit. Megjithatë, në 2019 kishte rritje në numrin e të punësuarve në sektorin e bujqësisë (nga 3.5% ndaj totalit në 2018, në 5.2% në vitin 2019).

Grafiku 5 Kreditë, depozitat dhe kreditë jo-performuese



Sektori bankar vazhdon të ketë rritje të përsheptuar në kreditim. Në fund të vitit 2019, stoku i kredive arriti vlerën prej rreth 3.03 miliardë Euro (3,032 milion) duke shënuar kështu një rritje prej 10.0% në krahasim me vitin paraprak. Kreditë e ndërmarrjeve janë rritur me 9.4% ndërsa ato të ekonomive familjare me 10.4%. Në fund të vitit 2019 totali i depozitave arriti vlerën prej rreth 3.9 miliardë Euro, duke shënuar kështu një rritje vjetore prej 16.2%,

nga të cilat depozitat e ndërmarrjeve kanë shënuar rënie për 14.3% (v-m-v), ndërsa ato të ekonomive shtëpiake kanë shënuar rritje vjetore prej 11.8%. Gjithashtu, niveli i kredive jo-performuese ka shënuar një rënie të vazhdueshme përgjatë viteve duke arritur në 2.0% në fund të vitit 2019 dhe reflekton një kualitet të mirë të kredive në vend. Norma mesatare e interesit të kredive gjatë vitit 2019 ishte 6.4%, rreth 0.2 p.p. më e ulët se në vitin e kaluar. Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita ishte 1.5%, duke shënuar një rritje prej 0.15 p.p.


Hapësirë Informuese 1. Krahasimi i parashikimeve makroekonomike në KASH-et e mëhershme me aktualet

Figura 1 paraqet krahasimin ndërmjet parashikimeve të treguesve kryesorë makroekonomikë të paraqitur në KASH-et e mëhershëm dhe performancës së tyre aktuale gjatë periudhës 2014-2018⁵ dhe ndihmon për të identifikuar nëse ka anim sistematik (qoftë për lartë apo për poshtë) në projeksione.

Siç është paraqitur në Figurën 1, norma e parashikuar e rritjes së BPV-së nominale për dy vitet e para (2014 dhe 2015) është më e lartë se të dhënat aktuale për shkak të rritjes më të madhe të konsumit, eksporteve dhe rritjes më të vogël të importeve; përderisa në vitin 2016 ky dallim zvogëlohet dukshëm ku BPV e parashikuar ishte shumë afër vlerave aktuale. Në vitin 2017, parashikimet për BPV-në ishin më konservative, duke qenë më të ulëta se sa performanca aktuale. Ndërsa në vitin 2018, BPV-ja nominale e projektuar është më e lartë se aktualja, edhe pse hendeku ndërmjet të dyjave është më i ngushtë se në të kaluarën. Ky hendek në vitin 2018 i atribuohet kryesisht pritjeve më të ulta të importit total se vlera aktuale (rreth 5 pikë përqindje më të ulta), ndërkohë që pritjet për komponentët e tjerë të PBV-së kanë qenë më të ulta se aktualet. Vlen të theksohet se hendeku ndërmjet projeksioneve të eksportit total dhe inflacionit është në nivele afër zeros gjatë vitit 2018.

⁵ Nuk është dhënë krahasimi për vitin 2019 për shkak se të dhënat tremujore për këtë vit janë preliminare deri në publikimin e të dhënave vjetore nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (Shtator 2020).

Figura 1. Variablat kryesore makroekonomike 2014-2018: Projektionet për KASH ndaj realizimit (aktualeve)



Shifrat më lartë paraqesin disa çështje me rëndësi për procesin e parashikimit të buxhetit:

Duke qenë se BPV-ja nominale përdoret si variabël makroekonomik kyç që ndikon në të hyrat buxhetore, vlerat më të ulëta aktuale të BPV-së sesa ato të parashikuara zakonisht⁶ kanë ndikim negativ në mbledhjen e të hyrave për ato vite krahasuar me parashikimet, veçanërisht për kategoritë e tatimeve në të ardhura personale dhe në të arra të korporatave;

Edhe pse dallimi (hendeku) në mes të konsumit të parashikuar dhe të aktual është ngushtuar dukshëm, ai prapë çon në pritje më të larta për të hyrat e mbledhura nga TVSH e brendshme.

⁶ Në kontekstin e Kosovës, përfitimet nga pëmbushja e obligimeve për tatimet direkte dhe TVSH-në e brendshme mund të mbivendosen (përkojnë) me efektet e variablave makroekonomike që ndikojnë në të hyrat tatimore.

Importet, me përjashtim të vitit 2015, janë nënvlerësuar duke çuar në parashikime më të ulta për të hyrat e mbledhura nga TVSH-ja në kufi dhe nga taksa doganore. Megjithatë, kjo pjesërisht kompensohet nga efekti pozitiv që ka një+ nënvlerësim i tillë i importeve në BPV-në e parashikuar dhe rrjedhimisht në projeksionet për të hyrat e tjera buxhetore (akciza).

Këto divergjenca ndërmjet projeksioneve dhe shifrave aktuale të variablave ekonomike mund të kenë kontribuar në të hyra më të ulëta sesa ato të parashikuara. Sidoqoftë, bilanci buxhetor dhe bilanci bankar kanë vazhduar të qëndrojnë brenda rregullave fiskale, ku deficiti buxhetor ishte më pak se 2% e BPV-së dhe bilanci bankar ishte jo më pak se 4.5%⁷ e BPV-së.

2.1.3. Perspektiva Makroekonomike 2020-2023

Në fillim të muajit mars të vitit 2020, Ministria e Financave azhurnoi projeksionet makro-fiskale në kuadër të hartimit të Buxhetit për këtë vit. Sipas këtyre projeksioneve, ekonomia e Kosovës vlerësohej të rritej në terma realë me rreth 4.2% (ngjashëm me trendin e vet historik), e shtyrë kryesisht nga konsumi dhe investimet publike. Në kohën e përgatitjes së Buxhetit 2020, gjasat e materializimit të skenarit të pandemisë COVID-19 në Kosovë apo të ndikimit të kësaj situate të sapofilluar në vendet e tjera u konsideruan si një rrezik i mundshëm por nuk u inkorporuan në skenarin bazë, si rezultat i pasigurisë që rrethonte përhapjen dhe magnitudën e kësaj pandemie dhe ndikimin që mund të kishte në ekonomi. Gjithashtu, deri në fillim të muajit mars, Kosova ishte një nga të paktat vendet në rajon dhe në botë që nuk kishte regjistruar asnjë rast të infektimit me COVID-19. Mirëpo, në një peridudhë një-mujore, situata dhe persepektiva ekonomike në Kosovë ka ndryshuar në mënyrë dramatike. Aktualisht, numri i të infektuarve është rritur në mbi 400 persona dhe masat apo vendimet e ndërmarra nga qeveria (kufizimi i lëvizjes dhe udhëtimit të njerëzve, ndalimi i veprimtarisë për një sërë aktivitetesh biznesore, mbyllja e shkollave, etj.) me qëllim parandalimin e përhapjes së mëtejshme të COVID19 janë shtrënguar gjithmonë e më shumë, të cilat pritet të kenë ndikim të ndjeshëm negativ në indikatorët kryesorë ekonomikë.

Aktualisht, të dhënat e vetme të disponueshme, të cilat mund të pasqyrojnë ndikimin e COVID-19 në ekonominë e Kosovës janë të dhënat fiskale (të hyrat dhe shpenzimet), tregtia e mallrave (bazuar në të dhënat e Doganës), inflacioni dhe indikatorë të tjerë “të butë”, siç mund të jenë pyetësorë apo intervista të ndryshme të realizuara nga Oda Ekonomike apo organizata të tjera me bizneset kryesore ose ndjesi të pasigurisë të reflektuara në aktivitetin e përditshëm të bizneseve dhe ekonomive familjare.

Ndryshe nga dy muajt e parë të vitit, ashtu siç tregon edhe tabela 1, importi i mallrave gjatë muajit mars 2020 ka shënuar rritje negative në terma vjetorë, si në sasi ashtu edhe në vlerë, çka reflekton jo vetëm ngadalësimin e kërkesës aggregate në vend por edhe çmimet më të ulta të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare. Rënia e importeve reflektohet pothuajse në të gjitha kategoritë e

⁷ Limiti prej 4.5% i bilancit bankar si përqindje e BPV-së aplikohet vetëm në ato vite kur janë përdorur fondet nga privatizimi i NSH-ve..

mallrave të importuara, me përjashtim të kategorisë së cigareve. Ngjashëm ka qenë edhe ecuria e eksporteve të mallrave gjatë tre muajve të parë të këtij viti.

Dinamika e ekzekutimit të shpenzime kapitale në muajin janar dhe shkurt, pavarësisht mosformimit të qeverisë së re dhe mungesës së një Buxheti të aprovuar për vitin 2020, edhe pse e ngadaltë ka qenë më e mirë se dy muajt e parë të vitit paraprak. Ndërkohë, në muajin mars kjo tendencë ndryshoi kah, duke u reflektuar në një ekzekutim të shpenzimeve kapitale me rreth 28 milionë Euro më të ulta se në muajin e njëjtë të vitit paraprak. Të hyra tatimore nga Dogana në muajin mars regjistruan një rënie vjetore prej 3%, duke qenë në linjë me ecurinë e importeve. Gjithashtu, të hyrat tatimore nga ATK-ja, pas një ecurie të kënaqshme në dy muajt e parë të vitit, regjistruan një rënie vjetore prej 31.5% (ose rreth 10 milionë Euro më të ulta) krahasuar me muajin mars të vitit të kaluar. Indeksi i Çmimeve të Konsumit gjithashtu ka vazhduar ecurinë e vet rënësë të nisur prej muajit janar, jo vetëm si rezultat i një baze të lartë në të njëjtën periudhë të vitit paraprak për shkak të tarifës 100% ndaj produkteve të Serbisë dhe të Bosnje&Herzegovinës, por edhe si rezultat i rënies së ndjeshme të çmimeve në tregjet për shkak të rënies drastike të udhëtimit apo të aktivitetit industrial në nivel global.

Tabela 1 Disa Indikatorë Ekonomikë

<i>Indikatorë, v-m-v, % nëse nuk ceket ndryshe</i>	<i>Janar '20</i>	<i>Shkurt '20</i>	<i>Mars '20</i>
Importi i Mallrave Sasi	41.1%	7.3%	-15.4%
Importi i Mallrave Vlerë	16.3%	12.7%	-12.8%
Eksporti i Mallrave Sasi	34.1%	11.1%	-23.0%
Eksporti i Mallrave Vlerë	27.0%	52.6%	5.1%
Të hyrat ATK	14.4%	5.9%	-31.5%
Të hyrat Dogana	9.3%	7.3%	-3.1%
Shpenzimet kapitale (diferenca mln EUR)	0.2	12.2	-27.6
IHÇK	1.5%	1.0%	0.7%


Përhapja e pandemisë COVID-19 në Kosovë, përveç aspektit të shëndetit publik, paraqet një sërë sfidash në rrafshin ekonomik dhe financiar. Analizimi i ndikimit të efektit të kësaj situatë në ekonominë e Kosovës kërkon të veçohen dy fenomene nga njëra tjetra. Së pari, zhvillimet aktuale dhe të ardhshme në numrin e rasteve të infektuara apo shkallës së vdekshmërisë do të kenë ndikim kryesisht në ecurinë afatgjatë të ekonomisë, duke qenë se do të ndikojnë drejtpërdrejtë në fuqinë punëtore të ekonomisë së Kosovës. Së dyti, masat e nevojshme të ndërmarra nga autoritetet e Kosovës për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të virusit COVID-19 do të jenë përcaktuesit kryesorë të ecurisë ekonomike në afatin e shkurtër. Duke patur parasysh shkallën e ulët të vdekshmërisë së pandemisë COVID19 dhe numrit të ulët të të infektuarve në Kosovë, pritjet janë që pjesa më e madhe e efekteve negative ekonomike të origjinojnë nga masat e ndërmarra për distancim social dhe rrjedhimisht të jenë të natyrës afatshkurtër.

Vlerësimi i ndikimit të këtyre masave në ekonominë e Kosovës është gjithashtu mjaft sfidues pasi ekzistojnë një sërë pasigurish të mëdha në lidhje me: i) kohëzgjatjen e situatës së COVID-19 në Kosovë; ii) shtrëngimit të masave kufizuese në lidhje me lëvizjen e njerëzve apo zhvillimit të aktivitetit biznesor; iii) zhvillimeve në ekonominë e jashtme dhe veçanërisht në vendet fqinje; apo

iv) stimujve fiskalë që ndërmerren nga autoritetet përkatëse (siç është rasti i Pakos Emergjente Fiskale të miratuar së fundmi).

Masat e ndërmarra deri tani në Kosovë për të kufizuar përhapjen e virusit COVID-19 priten të kenë ndikim të dyfishtë në ekonominë e Kosovës. Nga njëra anë, ndalimi i përkohshëm i aktivitetit biznesor për disa sektorë do të çojë në uljen e ofertës së mallrave dhe shërbimeve në treg. Nga ana tjetër, karantinimi dhe kufizimi i qarkullimit në ekonominë e jashtme do të ulë kërkesën në ekonomi nëpërmjet kanaleve të remitançave apo të udhëtimit në Kosovë. Gjithashtu, situata e ngjashme në Kosovë pritet të ndikojë në kërkesë më të ulët për mallra dhe shërbime, në të ardhura më të ulta dhe në investime më të ulta nga ana e sektorit privat. Në kushtet e një ambienti që ndryshon me shpejtësi, është mjaft e vështirë të kuantifikosh impaktin e këtyre masave në situatën ekonomike, edhe pse është e qartë që ato do të çojnë në një kontraktim të ndjeshëm të prodhimit, shpenzimit të ekonomive familjare, investimit të korporatave dhe tregtisë ndërkombëtare. Duke marrë parasysh të gjitha këto, rritja ekonomike reale për vitin 2020 është rishikuar ndjeshëm për poshtë, duke u luhatur tashmë në vlera negative, rreth -2%, me goditjen më të madhe të reflektuar në tremujorin e dytë, për t'u ndjekur nga një rimëkëmbje graduale në tremujorët pasardhës të vitit. Gjatë vitit 2021, ekonomia e Kosovës pritet të rritet me një normë reale mbi trendin e vet historik, me rreth 5.4%, por megjithatë niveli i BPV-së do të jetë më i ulët se niveli i parashikuar në skenarin bazë para situatës së COVID-19. Megjithatë, sa më shumë të zgjasë periudha e distancimit social apo izolimit, aq më të vogla janë gjasat për një rimëkëmbje të ekonomisë sipas një trajektore të formës V (siç është paraqitur në grafik 6). Ndërsa, në dy vitet e tjera (2022 dhe 2023), rritja ekonomike do të luhetet rreth nivelit prej 4%.

Grafiku 6 BPV-ja sipas komponentëve BPV-ja sipas komponentëve



Një prej kanaleve kryesore të transmetimit të kësaj krize pandemie janë *dërgesat e emigrantëve*, të cilat historikisht kanë përbërë një nga burimet kryesore të financimit të jashtëm në Kosovë (mbi 10% e BPV-së). Gjatë vitit 2020, remitançat priten të bien ndjeshëm, me mbi 12% krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i pritjeve për përkeqësimim të konsiderueshëm të situatës ekonomike në vendet ku ndodhen emigrantët e Kosovës. Kjo ecure rënëse e remitançave pritet të vazhdojë edhe

në vitin pasardhës (2021), duke patur parasysh reagimin me vonesë kohore të remitancave ndaj zhvillimeve ekonomike; ndërkohë që në dy vitet e tjera (2022 dhe 2023) ecuria e tyre pritet të stabilizohet. *Investimet e huaja direkte*, të cilat kryesisht janë të përqëndruara në sektorin e patundshmërisë (rmbi 80%) pritet të jenë në nivele afër zeros gjatë tremujorit të dytë të 2020-ës, e cila më tej do të reflektohet edhe në përkeqësimin e sektorit të ndërtimit në ekonominë e Kosovës. *Kreditimi bankar* gjithashtu gjatë tremujorit të dytë pritet të reduktohet në nivele shumë të ulta si rezultat i kërkesës nga ana e individëve apo bizneseve por edhe si rezultat i shtrëngimit të ofertës nga ana e bankave, në kushtet e rritjes së pasigurisë që rrjedhimisht reflektohet në rritje të rrezikut të aftësisë paguese të kredimarrësve. *Punësimi* në sektorin privat pritet të përkeqësohet si rezultat i humbjes së vendeve të punës, veçanërisht në ata sektorë që janë të ndikuar direkt nga kjo krizë (sektori i shërbimeve; i tregtisë me pakicë, transportit etj).

Të gjithë faktorët e përmendur më lartë kombinuar me rritjen e pasigurisë në vend pritet të ndikojë në një ngadalësim të ndjeshëm në konsumin dhe investimin privat, që vlerësohen të shënojnë një rënie vjetore reale me rreth -0.5% dhe -9.2%, respektivisht. Ndërsa në vitin 2021, konsumi dhe investimi privat do të përshpejtohet ndjeshëm, duke shënuar norma rritje reale mbi nivelin e tyre historik, për t'u stabilizuar gjatë viteve 2022 dhe 2023.

Eksporti i shërbimeve, i cili karakterizohet nga një komponent i lartë i udhëtimeve, pritet të shënojë rënie të konsiderueshme në tremujorin e dytë të 2020-ës si rezultat i kufizimeve strike mbi udhëtimin. Ngjashëm do të jetë edhe ecuria e *importit të shërbimeve*. Gjatë vitit 2020, eksporti dhe importi i shërbimeve, në terma realë, do të shënojnë një rënie vjetore prej më shumë se 8%, ndërsa në vitet pasuese ecuria e tyre do të jetë në linjë me trendin historik. *Eksporti i mallrave* do të ndikohet negativisht (rënie vjetore reale prej 5.2%) kryesisht si rezultat i kërkesës të ngadalësuar në ekonominë e jashtme por edhe çmimeve të ulta që po karakterizojnë tregjet ndërkombëtare (veçanërisht çmimi i nikelit). *Importi i mallrave* do të bjerë ndjeshëm (me rreth -7.4% krahasuar me vitin e kaluar – në terma realë) duke qenë në linjë me ngadalësimin në konsumin privat, investimet private dhe ekzekutimin e ngadalë të shpenzimeve publike. Në vitin 2021, ecuria e eksportit dhe importit të mallrave do të përmirësohet ndjeshëm, duke shënuar një rritje vjetore reale prej 7.0% dhe 13.6%, respektivisht.

Investimi publik pritet të ngadalësohet krahasuar me vitin e kaluar si rezultat i situatës së krijuar nga COVID-19, e cila ka kërkuar krijimin e një hapësire fiskale për të akomoduar shpenzimet e nevojshme dhe esenciale në këtë situatë, siç është rasti i Pakos Emergjente Fiskale e miratuar nga Qeveria së fundmi, e cila pritet t'i ndihmojë ekonominë familjare dhe bizneset në tejkalimin e kësaj situatë të vështirë. Si rrjedhojë e kësaj të fundit, shpenzimet rrjedhëse të qeverisë priten të tejkalojnë shumën e buxhetuar dhe të shënojnë një rritje vjetore prej 6.8%, e cila kryesisht i atribuohet rritjes së kategorisë “subvencione dhe transfere”, gjë e cila do të çojë në rritjen e konsumit publik me rreth 3.4% (në terma realë), duke përbërë komponentin e dytë (pas importit) që pritet të ketë kontribut pozitiv në BPV-në reale.

Indeksi i Çmimeve të Konsumit pritet të luhatet rreth nivelit 1.4% gjatë vitit 2020, duke qëndruar ndjeshëm më poshtë se niveli i shënuar në vitin 2019 (2.7%). Presionet inflacioniste në kategorinë

e “ushqimeve dhe pijeve alkoolike” që mund të vijnë nga shtrembërimet në zinxhirin ushqimor priten të dominohet nga presionet disinflacioniste që mund të vijnë nga heqja e tarifës 100% nga produkteve të Serbisë dhe të Bosnje&Herzegovinës dhe nga rënia drastike e çmimeve të mallrave primare (nafta, metale bazë, etj.) në tregjet ndërkombëtare. Ndërkohë, duke filluar prej fundit të vitit 2020 dhe vitin pasardhës, inflacioni pritet të ndjekë një ecuri rritëse në linjë më gjallërimin e ekonomisë dhe ri-kthimit të çmimeve në tregjet e huaja drejt niveleve të tyre historike. Në periudhën afatmesme (2021- 2023), inflacioni pritet të luhatet rreth nivelit 2%.

Hapësirë Informuese 2. Krahassimi i parashikimit makroekonomik për KASH-in 2021-2023 me institucionet e tjera

Tabelat në vijim paraqesin projeksionet e normës së rritjes së BPV-së reale (nëse është në dispozicion) në mesin e institucioneve të ndryshme⁸ për periudhën afatmesme. Një krahasim i tillë mundëson gjykimin se a janë projeksionet makroekonomike të MFT-së në përputhje me ato të institucioneve të tjera (vendore dhe ndërkombëtare). Siç tregon tabela 1, të gjitha institucionet për vitin 2020 presin një rënie të aktivitetit ekonomik si rezultat i masave të ndërmarra për parandalimin e COVID-19, për t’u ndjekur nga një rimëkëmbje e shpejtë në 2021. Të gjitha institucionet theksojnë se se skenari i tyre bazë rrethohet nga një shkallë e lartë pasigurie dhe nga nja balancë e rreziqeve të zhvendosur ndjeshëm për poshtë. Projeksionet e MFT-së janë më optimiste se mesatarja e vlerësimeve të institucioneve të tjera. Po ashtu, MFT-ja pret një shkallë më të ulët të inflacionit se institucionet e tjera. Sa i përket BPV-së nominale, projeksionet e Ministrisë së Financave janë më të larta se ato të Fondit Monetar Ndërkombëtar veçanërisht në vitin 2020 (rreth 2.3% më të larta).

Tabela 1: Projeksionet e rritjes së BPV-së reale në mesin e institucioneve					
Viti	2019	2020	2021	2022	2023
MFT (Prill '20)	4.0%	-2.1%	5.4%	4.1%	4.0%
Banka Qendrore e Kosovës (Prill '20) ⁹	3.9%	-3.0%			
Banka Botërore (Prill '20)	4.2%	-4.5%	5.2%	n/a	n/a
FMN (Prill '20)	4.0%	-5.0%	7.5%	3.7%	3.8%
Mesatarja e të tjerëve	4.0%	-3.2%	6.0%	3.9%	3.9%

Tabela 2. Projeksionet e BPV-së nominale (në mil euro) në mesin e institucioneve					
Viti	2019	2020	2021	2022	2023
MFT (Prill '20)	7,114	7,033	7,561	8,003	8,465
FMN (Prill '20)	7,125	6,877	7,476	7,870	8,305

Tabela 3. Projeksionet e shkallës së inflacionit në mesin e institucioneve					
Year	2019	2020	2021	2022	2023
MFT	1.7%	0.9%	2.0%	1.7%	1.7%
Banka Botërore	2.7%	1.6%	1.8%	n/a	n/a
FMN	2.7%	1.3%	1.6%	1.8%	1.8%
Mesatarja e të tjerëve	2.7%	1.6%	1.9%	1.5%	1.8%

⁸ Projeksionet e institucioneve të tjera janë marrë nga përditësimet e tyre të fundit dhe jo të gjitha prej tyre mbulojnë të njëjtin horizont të parashikimit. Kllapat në tabela paraqesin datën e përditësimit të fundit për secilin institucion.

⁹ Projeksionet e Bankës Qendrore janë të disponueshme vetëm në konferencën për media të Guvernatorit të BQK-së (<https://www.bqk-kos.org/?id=104&l=1731>), dhe janë të dhëna në formë intervalore [-4%: -2%] - në tabelë është paraqitur pika e mesit e këtij intervali.

2.2. KORNIZA FISKALE 2021-2023

2.2.1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET QEVERTARE

2.2.1.1. Të hyrat dhe shpenzimet në vitin 2020

Në vitin 2020, situata dhe persepektiva ekonomike në Kosovë ka ndryshuar për shkak të pandemisë COVID-19. Ndikimi në ekonomi i pandemisë dhe masave të ndërmarra nga qeveria kanë bërë që parashikimet fiskale për këtë vit të ndryshojnë krahasuar me projeksionet e buxhetit 2020. Vlerësimet për të hyrat totale nga Ministria e Financave për vitin 2020 tregojnë që të hyrat do të kenë një rënie vjetore prej rreth 5.3%, shtyrë nga një aktivitet ekonomik i ngadalësuar.


Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore në vitin 2020 priten të kenë një rritje prej rreth 14% krahasuar me vitin e kaluar. Megjithatë, struktura e shpenzimeve ka pësuar ndryshime për shkak të akomodimit të shpenzimeve që rrjedhin nga Pakoja Emergjente Fiskale.

2.2.1.2. Parashikimi i të hyrave për periudhën 2021-2023

Të hyrat buxhetore për periudhën afatmesme priten të stabilizohen, duke u bazuar në projeksionet makroekonomike, uljen e stokut të borxhit tatimor dhe efektet e politikave fiskale.

Rrjedhimisht, **të hyrat e përgjithshme buxhetore** priten të rriten mesatarisht me 8.3% përgjatë periudhës afat-mesme. Rritja e parashikuar është më e theksuar në 2021 kryesisht për shkak të efektit bazë nga 2020 dhe rimëkëmbjes së ekonomisë pas pandemisë.

Grafiku 7 Struktura e të hyrave në të hyrat e të përgjithshme



Të hyrat nga tatimet indirekte vazhdojnë të kenë pjesëmarrjen më të lartë në të hyrat e përgjithshme dhe priten të rriten rreth 8.6% në periudhën afatmesme. TVSH-ja pritet të rritet mesatarisht me 9.8%, e shtyrë nga rritja e importit të mallrave dhe të konsumit të përgjithshëm. Gjithashtu, vlen të theksohet që në rritjen e të hyrave nga TVSH vendore efekt pozitiv kanë edhe eksportet e shërbimeve të udhëtimit, të cilat kryesisht përfaqësojnë zakonisht konsumin e emigrantëve gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë. Të hyrat nga akciza parashihen të rriten në linjë

me rritjen reale të BPV-së mesatarisht me 4.5%, ndërsa të hyrat nga detyrimi doganor pritet të rritet mesatarisht me 16.1% në periudhën afatmesme bazuar në rritjen e importeve si dhe zvogëlimin e efektit negativ të MSA.

Në anën tjetër, **të hyrat nga tatimet direkte** pritet të rriten mesatarisht rreth 9.1% në periudhën afatmesme. Rritja më e theksuar është në vitin 2021 si rezultat i një rimëkëbjeje të ekonomisë pas tkurrjes në 2020 të shkaktuar nga masat e ndërmara për luftimin e pandemisë COVID-19. Përveq kësaj, kjo rritje është shtyrë edhe nga ulja e borxhit tatimor në kuadër të tatimeve në të ardhura të korporatave dhe në të ardhura personale.

Të hyrat jo-tatimore parashihet të kenë një rritje prej 6.3% në periudhën afatmesme mirëpo ato pritet të kenë një rënie së përqindje të BPV-së nga 3.0% në vitin 2020 në 2.8% në fund të periudhës afatmesme. Parashikimi pasqyron qëndrimin e politikave të Qeverisë për të shmangur mbështetjen në të hyrat jo-tatimore mirëpo, një zbatim më dinamik i procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje dhe përmirësimi i përmbushjes së regjistrimit të automjeteve mund të kontribuojnë në të hyra më të larta se sa ato të parashikuara për arkëtimin e të hyrave jo-tatimore.

Hapësirë Informuese 3. Krahasimi i parashikimeve buxhetore dhe aktualeve për vitin 2019

Tabela 1 në Aneks 2 mundësojnë krahasimin e performancës së zërave buxhetorë kryesorë sipas realizimit të tyre, në buxhet dhe KASH (atë fillestar dhe më të fundit) për vitin 2019.

Sa i përket shpenzimeve, vrojtimi kryesor është se shpenzimet rrjedhëse në KASH (2019- 2021) janë nënvlerësuar për shkak të rritjes së numrit të përfituesve në skemat pensionale, si rezultat i mos reformimit të skemës për veteranët e luftës, gjë e cila do të mundësonte zvogëlimin e numrit të përfituesve në këtë kategori dhe për shkak të vendimit për rritjen e pensioneve bazike dhe kontributdhënësve për 20% dhe 15% gjatë vitit 2019-ës. .

Ndërsa shifrat aktuale për shpenzime rrjedhëse krahasuar me buxhetin 2019 ishin më të ulta, për shkak të një nën shpenzimi në paga dhe mëditje dhe në mallra e shërbime, edhe pse kategoria e subvencioneve dhe transferove kishte një mbi-shpenzim. Ky nënshpenzim tek kategoria e “pagave dhe mëditjeve” dhe “mallrave dhe shërbimeve” ishte kryesisht për shkak të mos plotësimit të numrit të vendeve të lira të punës, aprovimit më të vonshëm të buxhetit (shkurt 2019), zgjedhjeve të parakohshme (tetor 2019) dhe lënies së një kontigjence në kategorinë e ‘mallrave dhe shërbimeve’, e cila në fund të vitit 2019 u rialokua për mbulimin e shpenzimeve në kategorinë ‘subvencione dhe transfere’.

Shpenzimet kapitale janë nën projeksionet e tyre si në KASH ashtu edhe në Buxhetin vjetor për dy arsye kryesore:

- 1) mos ekzekutimit të klauzolës së investimeve për shkak të vështirësive në funksionimin efikas të njësive implementuese dhe të vonesave të projekteve;

2) mos ekzekutimit të projekteve kapitale të financuara nga buxheti i rregullt për shkak të vështirësive në vendimmarrje meqë viti 2019 ishte vit zgjedhor si dhe buxheti ishte aprovuar me vonesë në shkurt 2020.

Në vitin 2019 kishte mospërputhje ndërmjet të hyrave të realizuara dhe projeksioneve të të hyrave si në KASH-in e fundit (2019-2021) ashtu edhe në buxhetin vjetor. Performanca më e ulët e të hyrave në vitin 2019 ishte përcaktuar kryesisht nga të hyrat e TVSH-së dhe akcizës. Kjo pjesërisht ishte e ndikuar Ligji për ndalimin e lojërave të fatit dhe nga performanca më e ngadaltë e importit të mallrave. Në anën tjetër, projeksionet kishin mbivlerësuar efektin negativ të Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asocimit në të hyrat nga detyrimi doganor. Ndërsa, të hyrat nga TAK dhe TAP dhe të hyrat jo tatimore kishin një mbiperformancë të lehtë

Tabela 2 Projektionet e të hyrave


Përshkrimi	2019	2020 Proj.	2021 Proj.	2022 Proj.	2023 Proj.
në milion Euro					
1. GJITHSEJ TË HYRAT BUXHETORE	1,889	1,788	2,007	2,126	2,255
<i>nga te cilat: nga ulja e stokut të borxhit tatimor</i>	22		27	27	27
1.1 Të Hyra Tatimore	1,662	1,563	1,767	1,884	2,006
Tatimet Direkte	292	280	327	345	363
<i>Tatimi në të ardhurat e korporatave</i>	95	88	104	109	115
<i>Tatimi në të ardhura personale</i>	166	158	179	189	199
<i>Tatimi në pronë</i>	27	29	37	40	43
<i>Të tjera</i>	5	6	6	6	7
Tatimet Indirekte	1415	1,326	1,489	1,591	1,698
<i>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar</i>	846	796	912	983	1,051
<i>Vendore:</i>	239	239	276	291	307
<i>Kufitare:</i>	606	557	636	691	744
<i>Detyrimi Doganor</i>	130	100	124	136	157
<i>Akcizë</i>	436	426	450	468	487
<i>Të tjera</i>	4	3	4	4	4
Rimbursimet tatimore	-46	-43	-48	-52	-55
1.2 Të Hyrat Jo-Tatimore	215	200	230	231	239
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Qendror</i>	122	105	128	127	131
<i>Taksa, ngarkesa dhe të tjera - Niveli Lokal</i>	50	47	50	50	50
<i>Taksa koncesionare</i>	11	13	17	20	23
<i>Renta Minerare</i>	29	30	30	30	30
<i>Të hyrat nga interesi (NP-ve)</i>	3	4	4	4	4
1.3 Grante për mbështetje buxhetore	11.5	25.0	10.5	10.5	10.5
1.4 Grante e përcaktuara të donatorëve	8.0	12.0	12.0	12.0	12.0

2.2.1.3.Parashikimi i shpenzimeve për periudhën 2021-2023

Shpenzimet buxhetore në periudhën afatmesme priten të stabilizohen pas pandemisë COVID 19 dhe gradualisht të rikthehen në nivelet e rritjes historike. Viti 2021 karakterizohet nga një rënie në disa prej kategorive të shpenzimeve kryesisht për shkak të efektit bazë të vitit 2020, kur ka patur një rritje të theksuar në disa kategori si rrjedhojë e masave stimuluese fiskale të qeverisë. Gjithashtu, shpenzimet janë planifikuar në atë mënyrë që të jenë në respektim të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të kompensojnë deficitin e tejkaluar mbi rregullën fiskale në 2020.

Përgjatë periudhës afatmesme 2021-2023, shpenzimet parashikohen të mbajnë një pjesëmarrje prej rreth mesatarisht 29.3% të BPV-së. Prej tyre, shpenzimet rrjedhëse pritet të jenë rreth 20.6% të BPV-së, ndërsa shpenzimet kapitale do të kenë një pjesëmarrje prej 8.1%. Një pjesë e shpenzimeve kapitale planifikohet të financohet nga huamarrja e jashtme përmes klauzolës së investimeve, e cila i mundëson Qeverisë të financojë projekte me interes publik dhe që ndikojnë në uljen e pengesave zhvillimore (infrastrukturore) të vendit.

Grafiku 8 Struktura e shpenzimeve buxhetore



Edhe pse gjatë kësaj periudhe është hasur vështirësi për të akomoduar shpenzimet si rezultat i kufizimeve ligjore për të kompensuar deficitin e tepruar në vitin 2020 për shkak të masave të marra për parandalimin e pandemisë, shpenzimet publike në periudhën afatmesme janë planifikuar të qëndrojnë pothuajse të pandryshuara. Në vitin 2021 parashihet një rënie në shpenzime për të vazhduar me një rritje në dy vitet pasuese. Kjo rënie në vitin 2021 sidomos në shpenzime rrjedhëse është kryesisht për shkak të efektit bazë të vitit 2020 ku shpenzimet rrjedhëse janë rritur për të akomoduar masat stimuluese fiskale. Në tabelën 3 është paraqitur struktura e shpenzimeve të përgjithshme qeveritare përgjatë periudhës afat-mesme e cila është planifikuar si në vijim:

Tabela 3 Struktura e Shpenzimeve

	2019	2020 Proj.	2021 Proj.	2022 Proj.	2023 Proj.
në milionë Euro					
GJITHSEJ SHPENZIMET BUXHETORE	2,091	2,383	2,276	2,373	2,374
Shpenzimet Rrjedhëse	1,537	1,766	1,631	1,645	1,669
<i>Paga dhe mëditje</i>	616	634	639	642	645
<i>Mallra dhe Shërbime</i>	294	308	353	385	364
<i>Subvencione dhe transfere</i>	627	781	631	640	652
<i>Rezerva rrjedhëse</i>	0	44	7.8	7.8	7.8
Shpenzimet Kapitale	531	583	599	684	651
<i>Financimi nga: Buxheti i rregullt</i>	384	510	467	564	624
<i>Klauzola e investimeve</i>	14	72.8	132	120	26
<i>Fondet e likuidimit (AKP)</i>	132	0	0	0	0
Interesi për Borxhin Publik	23	33	46	44	54

Shpenzimet Rrjedhëse në periudhën afatmesme planifikohen të kenë një rënie prej 1.8% e cila vjen kryesisht nga një rënie në vitin 2021 (-7.7%) dhe një rritje e lehtë në vitin pasues. Kategoria e shpenzimeve për **paga dhe mëditje** planifikohet të rritet me një mesatare prej rreth 0.6% përgjatë periudhës së ardhshme afat-mesme.

Kategoria e **mallrave dhe shërbimeve** pritet të rritet me një mesatare prej 6.0% në periudhën afatmesme kryesisht për shkak të rritjes së ndjeshme në vitin 2021, si rezultat i një baze të ulët në vitin 2020 dhe shpenzimeve shtesë për zgjedhjet komunale (rreth 5 mln Eur) dhe regjistrimit të popullsisë (rreth 7 mln Eur) në 2021 . Megjithatë, përkundër këtyre ndryshimeve, shpenzimet për mallra dhe shërbime pritet të jenë mesatarisht 4.5% në raport me BPV.

Subvencioneve dhe transferet, pritet të kenë një rënie prej 5.3% kryesisht si rezultat i shpenzimit të lartë në vitin 2020 për të akomoduar transferet dhe subvencionet në kuadër të masave të qeverisë gjatë pandemisë. Shpenzimet në këtë kategori pritet të jenë 8.1.% në raport me BPV-së gjatë periudhës afatmesme.

Shpenzimet kapitale - përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shpenzimeve të përgjithshme dhe pritet të përfaqësojnë rreth 27.5% të shpenzimeve totale në periudhën afatmesme. Gjatë kësaj periudhe, pritet implementimi i projekteve kapitale bazuar në një listë prioritete që përmban projekte me ndikim në përmirësimin e rrjetit të transportit, përmirësimin e rrjetit të energjisë elektrike dhe përmirësimin e kushteve në arsim, sistemin social dhe atë shëndetësor. Kjo kategori e shpenzimeve pritet të rritet me një normë prej 4% në periudhën afatmesme. Pjesa më e madhe e investimeve kapitale gjatë periudhës së ardhshme afatmesme pritet të jetë nga financimi i buxhetit të rregullt, mirëpo një numër i madh i projekteve në sektorë të ndryshëm planifikohet të financohet nga huazimi i jashtëm përmes klauzolës së investimeve (Kutia 1 në aneks).

Hapësirë Informuese 4. Pako Emergjente Fiskale si përgjigje ndaj situatës së emergjencës së shëndetit publik (COVID-19)

Më 30 Mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Vendimin për Pakon Emergjente Fiskale, e cila synon të adresojë problemet ekonomike-sociale të shkaktuara nga pandemia COVID-19. Kjo pako konsiston gjithsej në 15 masa, të cilat kanë si qëllim ndihmesën e mënjehershme të qytetarëve apo të atyre biznesve që janë dëmtuar më së shumti nga kufizimet e vendosura nga qeveria në lidhje me kufizimin e ushtrimit të aktivitetit ekonomik për disa sektorë dhe të lëvizjes së qytetarëve. Synimi i këtyre masave nuk është kompensimi i të gjitha efekteve negative por orientohet drejt minimizimit të dëmeve të shkaktuara nga kjo situatë emergjence e shëndetit publik.

Kjo pako arrin vlerën 180 milionë Euro dhe përbën rreth 2.4% të Bruto Produktit Vendor dhe do të pasohet me një pako shtesë, që pritet të ndikojë perspektivën afatmesme të ekonomisë duke rigjallëruar ekonominë, prodhimin dhe punësimin pas përfundimit të pandemisë dhe heqjes së masave kufizuese. Më poshtë gjendet përbërja e detajuar e masave të Pakos Emergjente Fiskale apo masave të tjera të ndërmarra si përgjigje ndaj kësaj situatë emergjence:

Tabela 1. Përbërja e Pakos Emergjente Fiskale dhe masave të tjera

MASAT	MBËSHTETJA	Përfitimi (EUR)/ Muaj	Kosto Totale, mln Eur	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
<i>Masa 1</i>	Pagesë e dyfishtë e skemës sociale		7.7	2.6	2.6	2.6		
<i>Masa 2</i>	Pagesë shtesë për përfituesit e skemave sociale dhe pensionale me pagesë mujore më të ulët se 100 euro	30	13		4.3	4.3	4.3	
<i>Masa 3: Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që janë në vështirësi financiare</i>	a) Mbulimi i shpenzimeve të pagave mujore të punonjësve	170 për person	41		20.5	20.5		
	b) Subvencion i qirasë për NVM	max 50%	12		6	6		
	c) Mbulimi i vlerës së kontributeve pensionale për pagat në pikën a)		8		4	4		
<i>Masa 4</i>	Sigurimi i huadhënies pa interes për ndërmarrjet publike, me kthim deri në fund të vitit		20		6.7	6.7	6.7	
<i>Masa 5</i>	Sigurimi i mbështetjes financiare për komunat të ndikuara nga pandemia		10		7	3		
<i>Masa 6</i>	Sigurimi i shtesës mbi pagë për punëtorët në terren dhe të ekspozuar direkt ndaj rrezikut të infektimit	300	15		7.5	7.5		

<i>Masa 7</i>	Pagesë shtesë për punëtorët e dyqaneve ushqimore, furrave dhe barnatorëve	100	3		1.5	1.5		
<i>Masa 8</i>	Pagesë e asistencës mujore për qytetarët që humbin vendin e punës për shkak të situatës	130	4		1.3	1.3	1.3	
<i>Masa 9</i>	Mbështetja e iniciativave dhe projekteve që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve jo shumicë, që janë goditur më rëndë nga situata		2		0.7	0.7	0.7	
<i>Masa 10</i>	Sigurimi i likuiditetit financiar për: mikro-ndërmarrjet, të vetëpunësuarit apo shoqëritë tregtare/kompanitë që ofrojnë shërbime bazike nëpërmjet programeve të caktuara të FKGK		15				7.5	7.5
<i>Masa 11</i>	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Bujqësisë për rritje të prodhimit bujqësor		5			2.5	2.5	
<i>Masa 12</i>	Rritja e buxhetit për grante dhe subvencione për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit		5			2.5	2.5	
<i>Masa 13</i>	Mbështetje për eksportuesit pas përfundimit të situatës së emergjencës		10					10
<i>Masa 14</i>	Mbështetje financiare për shoqëritë tregtare që regjistrojnë punëtorët me kontratë punë së paku (1) vjeçare gjatë periudhës së situatës së emergjencës	130	6		3	3		
<i>Masa 15</i>	Pagesa e asistencës mujore për qytetarët me kushte të rënda sociale, të lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent dhe që nuk ajnë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës.	130	3		1	1	1	
Shuma Totale e Pakos Fiskale Emergjente			179.7	2.6	66.1	67.1	26.5	17.5
Masë shtesë	Rritja e shpenzimeve në kategorinë "Mallra dhe Shërbime" për Ministrinë e Shëndetësisë		10		5	5		

Shënim: Ngjyra vjollcë e lehtë i përket kategorisë "Subvencione dhe Transfere"; ngjyra e gjelbër i përket "Huadhënie ndaj NP"; ngjyra gri e lehtë i përket "Mallra&Shërbime"; ndërsa ngjyra e verdhë i përket "Paga&Mëdtije"

2.2.2. Deficiti buxhetor dhe rregulla fiskale

Për periudhën 2021-2023 janë ndërmarrë masa për të kompensuar deficitin e tejkaluar në vitin 2020 për shkak të situatës së shkaktuar nga pandemia, bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike. Për këtë periudhë janë bërë përshtatje në mënyrë që pozita e përgjithshme fiskale të mbetet e qëndrueshme, duke kompensuar deficitin e tejkaluar në 2020 dhe duke ruajtur bilancin e përgjithshëm buxhetor.¹⁰ Si rrjedhojë, deficiti buxhetor sipas rregullës fiskale pritet të luhatet rreth vlerës -1.6% në vitin 2021, për t'u ndjekur nga një ecuri rënëse në vitin 2022 dhe 2023, duke shënuar vlerën -1.5% dhe -1.0% e BPV-së, respektivisht.

Si pjesë e strategjisë së financimit 2021- 2023, Qeveria synon të ruajë nivelin e borxhit të jashtëm duke u përqendruar në financim dhe ofrim të zotimit/garancionit në disa prej projekteve kyçe, kryesisht në fushën e infrastrukturës dhe shëndetësisë. Nevoja e Qeverisë për financim është bërë mbi bazën e një planifikimi të rregullt për borxhin e brendshëm dhe atë të jashtëm, duke e mbajtur borxhin e përgjithshëm publik në nivele të arsyeshme dhe të qëndrueshme. Bilanci bankar gjatë periudhës afatmesme pritet të luhatet rreth vlerës 3.7% e BPV-së nominale, respektivisht sipas kritereve të LMFP-së dhe duke patur parasysh mungesën e fondeve të likuidimit gjatë kësaj periudhe.

Hapësirë Informuese 5. Devijimet kryesore ndërmjet KASH-ve 2021- 2023 dhe 2020- 2022 për vitet 2021 dhe 2022

Tabelat 2 dhe 3 në Aneks 2 identifikojnë dhe shpjegojnë ndryshimet në të hyra dhe shpenzime mes KASH 2020-2022 dhe KASH 2021-2023. Tabela 2 paraqet devijimet në parashikimet për vitin 2021 ndërsa tabela 3 paraqet devijimet për vitin 2022.

Sa i përket të hyrave buxhetore, kemi devijime të ngjashme në të dy vitet dhe vjen kryesisht nga të hyrat tatimore indirekte sikurse akciza, TVSH kufitare dhe detyrimi doganor. Këto devijime vijnë kryesisht nga efekti bazë apo efekti i bartur nga viti 2020. Viti 2020 si pasojë e pandemisë dhe masave parandaluese të qeverisë, kishte një rënie të theksuar në aktivitetin ekonomik dhe si rrjedhojë edhe një rënie në të hyra e sidomos në ato indirekte. Për këtë arsye, dallimet e dukshme në të hyra krahasuar me KASH-in e kaluar vijnë nga nivelet më të ulëta të të hyrave, përkundër rritjes së tyre krahasuar me vitin 2020. Shpenzimet buxhetore gjithashtu në të dy vitet 2021 dhe 2022 janë më të ulëta se sa ato të planifikuara në KASH-in e kaluar. Këto devijime janë për disa arsye. Së pari, tejkalimi i deficitit në vitin 2020 kërkon që ai tejkalim të kompensohet në periudhat pasardhëse. Së dyti, aktiviteti ekonomik i parashikuar në këto dy vite është më i ngadaltë se sa ai i paraparë në KASH-in e kaluar dhe ka ndikuar që fatura e pagave të ketë një rritje më të ngadaltë; Së treti, ka ndodhur një rishikim i projekteve në klauzolën e investimeve bazuar në probabilitetin e realizimit të tyre.

¹⁰ Duhet cekur se asnjë Ligj për ndarjet buxhetore nuk duhet të përfshijë një deficit të përgjithshëm që kalon nivelin prej 2% të BPV-së së parashikuar. Por, në raste të caktuara me ligj lejohet devijimi nga ky obligim ligjor. Kështu, Neni 11 i Ligjit Nr.04/L-194 sqaron obligimet e shtetit për të kompensuar brenda tri viteve fiskale një deficit të tepruar qoftë brenda 3 viteve fiskale nëse deficiti i tepruar ka qenë më i vogël se 1%, ose brenda 5 viteve në rast të një deficiti të tepruar më të lartë.

2.2.2.1. Niveli i borxhit shtetëror, zhvillimet dhe perspektiva për vitet në vijim

Borxhi i përgjithshëm shtetëror në fund të vitit 2019 ishte 1,201.05 milionë Euro, prej të cilave 791.94 milionë Euro borxh i brendshëm, ndërsa 409.10 milionë Euro borxh ndërkombëtar, sic janë prezentuar në tabelën e mëposhtme. Portofoli i Borxhit të Përgjithshëm në fund të vitit 2019 përbëhej nga Borxhi i Brendshëm dhe Borxhi Ndërkombëtar, dhe nuk kishte Borxh Komunal dhe as Garanci Komunale të emetuara. Gjithashtu përmbante tri garanci shtetërore në vlerën 42.68¹¹ milionë Euro.

Tabela 4 Borxhi i Përgjithshëm

	2015	2016	2017	2018	2019
Borxhi Ndërkombëtar	371.17	373.77	422.15	416.43	409.10
Borxhi i Brendshëm	377.78	478.97	574.27	676.62	791.94
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm	748.95	852.74	996.42	1,093.05	1,201.05
Garancitë Shtetërore	10.00	20.00	44.00	43.70	42.68
Gjithsej Borxhi i Përgjithshëm (% e BPV-së)	13.07	14.38	16.62	16.90	17.46
BPV	5,807.01	6,070.11	6,413.86	6,725.91	7,123.10

Borxhi i brendshëm e ka tejkaluar borxhin ndërkombëtar për herë të parë në vitin 2015, dhe që nga atëherë ka vazhduar me trend të tillë rritës në favor të borxhit të brendshëm. Kjo pjesë e portofolit së borxhit të Kosovës përbëhet nga instrumente të borxhit me maturitet prej 1 viti deri në 10 vite. Ministria e Financave dhe Transfereve që nga fillimi i emetimit të letrave me vlerë (viti 2012) është përqendruar në financimin e buxhetit kryesisht nga tregu i brendshëm, duke kontribuar në zhvillimin e tregut. Përmes letrave me vlerë, Qeveria e Kosovës ka huazuar fonde me kushte të favorshme si dhe ka kontribuar në zhvillimin e tregut të Letrave me Vlerë. Në fund të vitit 2019 borxhi i brendshëm shënoi vlerën 791.94 milionë Euro, apo 66% e borxhit të përgjithshëm. Ndërsa deri në fund të vitit 2020, parashihet që borxhi i brendshëm të arrijë në 962.09 milionë Euro ose 13.68% e BPV-së.

Pjesa tjetër e borxhit shtetëror të Kosovës është borxhi ndërkombëtar i cili sipas fundit të vitit 2019 përbëhej nga programi¹² me Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN), huazimet nga Banka Botërore (BB), Banka Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane për Investime (BEI) dhe kreditorë tjerë me pjesëmarrje të vogël. Përfshijtur programin me FMN dhe borxhin e trashëguar, të gjitha huazimet tjera janë të lidhura me financimin e projekteve specifike në sektorë të ndryshëm. Në fund të vitit 2019 borxhi ndërkombëtar shënoi vlerën 409.10 milionë Euro, apo 34% e borxhit të përgjithshëm. Deri në fund të vitit 2020, stoku i borxhit ndërkombëtar parashihet të arrijë në milion 602.45 milionë euro ose rreth 8.57% e BPV-së. Në vijim është paraqitur gjendja aktuale e portofolit të borxhit

¹¹ Kredia e garantuar për Trafikun Urban ka filluar kthimin, dhe rrjedhimisht Garancia Shtetërore zvogëlohet për shumën e kthyer.

¹² Stand By Arrangement 2015

ndërkombëtar përfshirë edhe borxhin e zotuar e të padisbursuar (që nënkupton të marrëveshjeve të cilat janë ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës por ende nuk kanë filluar të disbursohen).

Tabela 5 Borxhi ndërkombëtar përfshirë edhe borxhin e zotuar e të padisbursuar sipas 31.12.2019

Kreditore	Borxhi i Ratifikuar Aktual (A)	Borxhi i Disbursuar (B)	Borxhi i Pa-disbursuar (C=A-B)	Borxhi i pakthyer (D=B-E)	Kthimi i Borxhit (E)	Borxhi i pa-disbursuar si % e BPV	Borxhi i disbursuar (pakthyer) % e BPV
IBRD	381.21	381.21	0.00	135.64	245.57	0.00%	1.90%
IDA	167.68	61.31	106.37	60.53	0.78	1.49%	0.85%
FMN	287.38	287.38	0.00	132.60	154.53	0.00%	1.86%
KFW	71.00	68.43	2.57	42.79	25.64	0.04%	0.60%
UniCredit	24.98	13.34	11.55	13.26	0.18	0.16%	0.19%
OFID, IsDB, SFD	47.50	13.05	34.19	12.15	1.16	0.48%	0.17%
EBRD	139.90	4.30	135.60	4.11	0.19	1.90%	0.06%
EIB	122.00	7.00	115.00	7.00	0.00	1.61%	0.10%
NATIXIS Franca	66.00	0.00	66.00	0.00	0.00	0.93%	0.00%
RBI Austria	5.13	1.03	4.10	1.03	0.00	0.06%	0.01%
Borxhi Ndërkombëtar	1,312.78	837.05	475.38	409.10	428.04	6.67%	5.74%

Shënim: Borxhi i ratifikuar aktual nënkupton shumën e përgjithshme të të gjitha marrëveshjeve financiare ndërkombëtare për kredi, të cilat janë të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Borxhi ndërkombëtar të kolona 'D' në tabelë ndryshon edhe si rrjedhojë e ndryshimit të kursit valutë për kreditë në valutën jo Euro.

Historikisht, niveli i Borxhit të Përgjithshëm i Qeverisë së Kosovës ka qenë relativisht i ulët. Por siç vërehet nga grafiku më poshtë, borxhi i Kosovës ka shënuar një trend rritës gradual. Nga të dhënat e mëposhtme, mund të vërehet se rritje do të ketë edhe në vitin 2020. Kjo do të ndodhë kryesisht për shkak të nevojës së financimit të deficitit për përballje me nevojat e menjëhershme shëndetësore dhe ekonomike të shkaktuara nga pandemia COVID-2019: (a) nga huazime shtesë nga tregu i brendshëm përmes Letrave me Vlerë, (b) marrjes së kredive nga pakot stimuluese të ofruara nga institucionet financiare ndërkombëtare, si dhe (c) një pjesë nga disbursimi i fondeve përmes klauzoles së investimeve.


Situata e re e krijuar nga pandemia COVID-19 ka paraqitur nevojën për fonde shtesë për përballje me situatën shëndetësore dhe ekonomike. Si rrjedhojë MFT për nevoja të menjëhershme ka paraparë rritjen e emetimit të letrave me vlerë në shumën prej 50 milion euro, duke preferuar metodën jo përmes ankandit publik. Lidhur me këtë po shqyrtohet mundësia që këto mjete të emetohen me vendosje private tek Fondet pensionale, në përputhje me ligjin për borxhin publik. Ky do të ishte instrument afatgjatë (së paku 10 vjeçar) që do të përkonte me strategjinë për zgjatjen e kohës mesatare të kthimit dhe strategjinë e Fondit për zgjatjen e maturitetit të portfolios së detyrimeve

dhe investimeve tyre - aseteve. Gjithashtu, përmes këtij investimi të Fondit do të përfitojnë drejtpërdrejt kontributdhënësit e Kosovës.

Në përgjigje ndaj nevojave emergjente të krijuara nga pandemia, Qeveria po shqyrton edhe përfitimin nga pakot emergjente dhe instrumentet e vecanta të IFN-ve ku Kosova është e antarësuar. FMN ka aprovuar dhe disbursuar Instrumentin për Financim të Menjëhershëm¹³ në shumën rreth 52 milionë Euro, për të lehtësuar nevojat urgjente që rrjedhin nga kriza. Kosova pritët të përfitojë edhe shumën prej 50 milionë Euro nga Banka Botërore (BB), po ashtu rreth 100 milionë Euro¹⁴ nga Bashkimi Europian (BE) për përballje me efektet e krizës (vetëm kreditë). Disa mundësi tjera të financimit janë duke u analizuar, por duhet pasur parasysh se sipas legjislacionit në fuqi mund të huazohet vetëm për aq sa është e paraparë në ligjin e buxhetit dhe një huamarrje e tillë duhet të ratifikohet përmes marrëveshjes financiare ndërkombëtare me 2/3 e votave.

Borxhi i Përgjithshëm në fund të vitit 2020 parashihet të jetë 1,564.54 milionë Euro ose 22.84%¹⁵ e BPV-së. Stoku i parashikuar për Borxhin e Përgjithshëm, përveç që përfshinë të dhënat nga Ligji i Buxhetit 2020 (Duke mos përfshirë DPL), gjithashtu përfshinë fondet shtesë emergjente nga institucionet financiare ndërkombëtare sikurse në vijim, FMN-në në shumën 52 milionë Euro, BB në shumën 50 milionë Euro dhe BE në shumën 50 milionë Euro, si dhe shumën shtese 50 milion Euro nga Letrat me Vlerë. Në figurën më poshtë është paraqitur trendi për stokun e Borxhit të Përgjithshëm.

Grafiku 9. Trendi i Borxhit të Përgjithshëm dhe si përqindje e BPV-së



Për shkak të kushteve të favorshme për huazim, në periudhën afat-mesme, Qeveria synon të orientohet lehtësisht drejt huamarrjes ndërkombëtare. Në këtë drejtim, do të rritet bashkëpunimi dhe komunikimi me institucionet financiare ndërkombëtare, në veçanti me ato zhvillimore, për të

¹³ <https://www.imf.org/en/News/Articles/2020/04/10/pr20149-kosovo-imf-executive-board-approves-us-million-emergency-support-address-covid-19-pandemic>

¹⁴ Prej të cilave 50 milion do të disbursohen në vitin 2020, dhe 50 tjera në fillim të vitit 2021

¹⁵ Borxhi si % ndaj BPV përfshinë edhe garancitë në vlerë 41.65 milion Euro (aktuale dhe të parashikuara për vitin 2020).

prezantuar projektet me prioritet për ekonominë e vendit dhe rrjedhimisht, për ti financuar këto projekte përmes kredive me kushte preferenciale nga këto institucione.

Ministria e Financave dhe Transfereve synon të zhvillojë edhe më tej tregun e brendshëm të Letrave me Vlerë të Qeverisë së Kosovës duke stimuluar dhe përkrahur zgjerimin e bazës së investitorëve. Zgjerimi i bazës së investitorëve planifikohet të bëhet duke emetuar instrumente të reja të borxhit të cilat në disa raste do të targetojnë grupe të reja në treg me potencial të madh investues. Gjithashtu fuqizimi i tregut sekondar, rritja e likuiditetit të letrave me vlerë përmes transaksioneve REPO në mes të bankave, por edhe me fillimin e zbatimit të këtyre transaksioneve edhe me BQK, pritet dinamizim i këtij segmenti.

Financimi i deficitit të buxhetit të Kosovës do të bëhet gjithnjë në konsistencë të plotë me nivelin e deficitit të paraqitur në Ligjin e Buxhetit si dhe nevojën për financimin e bilancit bankar. Në çdo rast, Ministria e Financave dhe Transfereve do të sigurohet që shuma e cila huazohet për nevojat e Qeverisë do të jetë me kosto më të ulët të mundshme dhe gjithnjë brenda kufijve të pranueshëm të ekspozimit ndaj rreziqeve të tregut. Për të garantuar menaxhim të mirëfilltë dhe strategjik të borxhit, Ministria e Financave dhe Transfereve përgatit çdo vit Programin e Borxhit Shtetëror i cili dokument është komplementar dhe në linjë me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve. Për sa i përket borxhit publik për periudhën që mbulon KASH, janë marrë për bazë huazimet për financimin e projekteve specifike (të atyre të nënshkruara, por të padibursuara si dhe të atyre që pritet të nënshkruhen). Për më tepër, skenari i parashikimeve ekonomike e fiskale merr për bazë edhe emetimin e letrave me vlerë, për financimin e deficitit. Dhe duke i marrë për bazë edhe kthimet për periudhën afatmesme, pritet një rritje graduale e stokut të borxhit të përgjithshëm, por totali i borxhit në raport me BPV-nw do të mbetet në nivele të pranueshme dhe të qëndrueshme.

Situata e re e paraqitur nga COVID-19, paraqet nevojën për rishikimin e disa prej treguesve kryesor makroekonomik, rrjedhimisht kjo kërkon edhe rishikimin e strukturës dhe burimeve të financimit, për t'ju përshtatur në kohë të duhur pasojave të pandemisë. Sidoqoftë, kufiri i borxhit publik mbetet brenda parametrave ligjor, me cilindo skenar që do të vendoset të financohet deficit (për shkak të rënies së të hyrave buxhetore) si dhe rritjes së presionit buxhetor në shpenzime.

2.3. RREZIQET AFATMESME 2021-2023

Korniza bazë e paraqitur në KASH përcillet, si çdo vit, me rrezeqe, të cilat mund ta ndryshojnë pasqyrën makro fiskale negativisht, varësisht nga probabiliteti i materializimit dhe intensiteti me të cilin realizohen, ato rrezeqe. Për hir të planifikimit të kujdesshëm dhe në interes të transparencës, pjesë e Kornizës Makro Fiskale do të jenë edhe këto rrezeqe fiskale në konsiderim, detajet e të cilave do të ofrohen në vijim. Krahasuar me vitin e kaluar, rreziqet janë ndjeshëm të shtuara, kryesisht me origjinë nga zhvillimet makroekonomike në vend.

Rreziqet sistematike (makroekonomike)

Ky nën-seksion paraqet efektet që devijimet nga projeksionet në makroekonomike të përdorura për KASH mund të kenë në agregatat kryesorë të buxhetit. Tabela 6 përshkruan se si devijimet pozitive dhe negative nga projeksionet makroekonomike të përdorura për KASH 2021-2023 ndikojnë në të hyra, shpenzime dhe bilanc buxhetor.

Kjo analizë e ndjeshmërisë tregon se zhvillimet e variablae makroekonomike përcaktojnë kryesisht performancën e të hyrave buxhetore e jo të shpenzimeve pasi që në Kosovë pak kategori të shpenzimeve janë direkt të lidhura me zhvillimet makroekonomike. Një shembull për këtë ndikim është inflacioni, me të cilin janë të ndërlidhura disa transfere sociale në buxhet.


Ligji Nr. 04/L-131 “Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti”, neni 5 përcakton se nëse ndonjë pension i paguar sipas këtij ligji rritet me ndonjë akt tjetër ligjor ose nënligjor, ose me ndonjë masë tjetër e autorizuar administrative, indeksimi me inflacionin ose me koston e jetesës do të aplikohet për dy vite kalendrike, duke filluar nga muaji kur rritja ka hyrë në fuqi. Pasi që në vitin 2019 ka pasur një rritje të pensioneve bazë dhe pensionet kontribut-dhënëse me vendim të qeverisë, nuk ka shpenzime të shkaktuara nga inflacioni që pritet në vitin 2021. Megjithatë, ka edhe fusha të tjera të shpenzimeve në buxhet të cilat nuk janë prekur nga ky vendim i qeverisë prandaj efekti i inflacionit aplikohet për to në 2021- 2023.

Projeksionet makroekonomike mbi të cilat është ndërtuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2021- 2023 bazohen mbi supozimin kryesor, sipas të cilit masat e distancimit social apo izolimit do të vazhdojnë të qëndrojnë të tilla kryesisht gjatë tremujorit të dytë, me tendencë normalizimi nga fundi i muajit qershor e tutje. Nën këtë supozim, ekonomitë familjare dhe bizneset menjëherë pas heqjes së këtyre masave do të jenë në gjendje t’i rikthehen gradualisht normalitetit të tyre, duke mos marrë parasysh hezitimin apo efektin psikologjik për të konsumuar apo investuar, i cili mund të mbizotërojë edhe pas tremujorit të dytë apo skepticizmin e tejzgjatur për të marrë pjesë në tubime shoqërore. Gjithashtu, skenari bazë nuk merr parasysh një kohëzgjatje apo persistencë më të madhe të pandemisë gjatë vitit 2020 apo në rastin më të keq gjasat e ndodhjes së një valë të dytë të pandemisë në vitin pasardhës (2021).¹⁶ Kombinimi i këtyre pasigurive që rrethojnë skenarin bazë (i cili është ndjeshëm më i ulët se projeksionet e realizuar në kuadër të Buxhetit 2020) do të

¹⁶ FMN-ja në WEO (Prill 2020) analizon tre skenare të ndryshme risku, ku njëri prej tyre supozon një kohëzgjatje më të madhe të situatës aktuale pandemike gjatë 2020-ës dhe ri-përsëritjen e një situatë të ngjashme (një valë e dytë) gjatë 2021-ës.

gjeneronte një rritje ekonomike reale mesatarisht 3.5 pikë përqindje më të ulët se rritja e projektuar në skenarin bazë për periudhën 2021- 2023.

Grafiku 10 Rritja ekonomike reale, v-m-v, %



Meqë Kosova është një ekonomi e hapur, e karakterizuar me një përqindje të lartë të importit në BPV (rreth 45%, zhvillimet e çmimeve në mallrat primare ndërkombëtare luajnë rol të rëndësishëm në ekonominë vendore. Në skenarin bazë të paraqitur në KASH 2021- 2023 është supozuar një rënie drastike e çmimeve në tregjet ndërkombëtare gjatë vitit 2020 si rezultat i pandemisë për t'u ndjekur nga një tendencë përmirësimi në vitin 2021 dhe tutje. Ngjashëm si në rastin e parë, nën supozimin se situata aktuale në të cilën ndodhemi do të zgjasë përtej tremujorit të dytë të vitit 2020, atëherë gjasat janë që rënia e çmimeve në tregjet ndërkombëtare do të jetë akoma dhe më e madhe. Një devijim prej 10% në indeksin ¹⁷ e “të gjitha mallrave primare” ka efekte negative në të hyrat buxhetore për shkak të ndikimit të tij në importe dhe ka një ndikim më të vogël në shpenzime për shkak të presionit të inflacionit që buron nga çmimet më të larta të mallrave.

Remitencat paraqesin një burim të rëndësishëm të financimit të jashtëm në Kosovë, duke përbërë rreth 12% të BPV-së gjatë viteve të kaluara. Këto prurje e kanë zbutur në mënyrë të konsiderueshme deficitin tregtar dhe kryesisht janë përdorur për konsum, duke zbutur kështu efektet negative të varfërisë dhe papunësisë së lartë në Kosovë. Në skenarin bazë, remitencat priten të shënojnë rënie prej 12% dhe 10% në vitet 2020 (me efektin kryesor negativ të shfaqur në tremujorin e dytë dhe tutje) dhe 2021, respektivisht si rezultat i zhvillimeve të pritura në Eurozonë. Mirëpo, nëse perspektiva ekonomike në vendet ku ndodhen emigrantët kosovarë përkeqësohet akoma më shumë, atëherë rënia në remitanca do të jetë akoma më e madhe. Një rënie në këto prurje transmetohet në të ardhura më të ulëta/më të larta të disponueshme e pastaj në konsum më të ulët/më të lartë i cili pastaj reflektohet në BPV dhe të hyra buxhetore më të ulëta/më të larta.

¹⁷ Një devijim prej 10% është devijim i përafërt standard i normave vjetore të rritjes të indeksit të “të gjitha mallrave primare”, që përfshinë lëndët djegëse (karburantin) dhe mallrat e tjera.

Tabela 6 Analiza e ndjeshmërisë së buxhetit ndaj luhatjeve të variablave makroekonomike për 2021- 2023

Variabla	Ndryshimi	Të hyrat		Shpenzimet	Bilanci buxhetor
		ndikimi në miliona euro	% e të hyrave të projektuara	ndikimi në milionë euro	
BPV nominale	3.5 pikë të përqindjes (-)	-210.8	2.90%		-210.8
Remitancat	10 për qind devijim (-)	-80.06	1.3%		-7.06
Indeksi i “të gjitha mallrave primare”	10 për qind devijim (+)	-16.68	0.27%	0.39	-17.07

Rreziqet specifike

1. Rreziku nga detyrimet kontigjente që rrjedhin nga kreditë e nën-huazuara dhe garancitë shtetërore

Në portofolin e borxhit shtetëror burim potencial të këtij rreziku paraqesin kreditë e garantuara të sektorit publik dhe kreditë ndërkombëtare të nën-huazuara nga Ministria e Financave dhe Transfereve ndaj kompanive që ofrojnë shërbime esenciale publike. Kreditë e garantuara në fund të vitit 2019 janë në shumën 42.68 milionë euro dhe përbëjnë me pak se 1% e borxhit të përgjithshëm. Pjesa e portofolit që mund të kërkojë monitorim më të afërt janë garancioni shtetëror ndaj Trafikut Urban dhe kreditë e nën-huazuara ndaj kompanive që ofrojnë të mira publike. Analizat e rreziqeve financiare dhe ekonomike kanë ngritur shqetësimet lidhur me performancën e dobët të kompanive publike. Një devijim më i thellë i rezultateve financiare të këtyre kompanive mund shkaktojë barrë për Qeverinë në afat të mesëm si për subvencionimin e shërbimeve që ato ofrojnë ashtu edhe për marrjen përsipër të obligimeve financiare ndaj kreditorëve të jashtëm.

Për të kufizuar ndikimin e rrezikut nga detyrimet e kontigjente do të vazhdojë të zbatohet një numër masash si: (a) monitorimi i pozitës financiare të përfituesve (b) vlerësimi fillestar i mundësisë së materializimit të detyrimeve kontigjente ekzistuese. Varësisht nga vlerësimet për humbjet e supozuara, do të përcaktohen edhe tarifat e garancisë të aplikueshme sipas Ligjit për Borxhin Publik. Si masë për menaxhimin e këtyre rreziqeve shërben edhe përfshirja e garancioneve në shumën e borxhit të përgjithshëm, në kalkulimin e kufirit të borxhit ndaj BPV-së

2. Nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale

Një rritje e shpenzimeve kapitale publike për të trajtuar pengesat strukturore është shtyllë e strategjisë së Qeverisë për të mbështetur një mjedis ekonomik miqësor për rritjen ekonomike. Në vitet e fundit, pavarësisht përmirësimeve, nën-ekzekutimi i shpenzimeve kapitale tejkalonte 5% të shumave totale të buxhetuara. Për qëllime të planifikimit të kujdesshëm, korniza 2021-2023 parasheh nivel historik të nën-ekzekutimit për projektet kapitale të financuara nga buxheti i rregullt ndërsa për projektet e financuara nga huazimi, supozimet janë edhe më konservative.

Megjithatë, nën-ekzekutimi i projekteve kapitale mbi supozimet e skenarit bazë, sidomos për projektet e huamarrjes, llogaritet si një rrezik i mundshëm për uljen e parashikimeve të rritjes. Kjo

pasi që ekzekutimi i projekteve kapitale të financuara nga borxhi koncesionar, pas nënshkrimit të marrëveshjeve financiare, mbetet ende sfidues për organizatat buxhetore, kryesisht si rezultat i një vendimmarrje më të nxituar për kredi, përkatësisht pa u siguruar se ekzistojnë të gjitha parakushtet, apo janë bërë përgatitjet e duhura, studimet dhe analizat e hollësishme (përfshirë analizat e tregut), që të sigurohet fillimi i menjëhershëm i implementimit të projekteve pas ratifikimit të kredive dhe që fondet nga kreditë të shfrytëzohen në mënyrë sa më efektive. Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm që mund të përkeqësojë më tej performancën e shpenzimeve kapitale është situata e krijuar nga pandemia COVID-10, gjatë së cilës aktivitetet ekonomike dhe ato administrative të palëve të ndërlidhura në këto projekte janë reduktuar në minimum duke shtuar vështirësitë në ekzekutimin e shpenzimeve kapitale apo shtyrjen e tyre në një kohë të mëvonshme. Faktorë të tjerë janë mos-harmonizimi i duhur i procedurave të prokurimit me ato të kreditorit në fillimin e procesit, pjesëmarrja jo e kënaqshme e zyrtarëve të Ministrive të Linjës gjatë procesit të negociimit të kredive, mos konsolidimi dhe jo stabiliteti i Njësisë Implementuese të Projekteve dhe mungesa e kapaciteteve për projekte.

3. Presioni për rritjen e shpenzimit për transfere

Siç është paraqitur në KASH 2021-2023, hapësira fiskale brenda kufirit ligjor të deficitit prej 2 për qind shkon deri në rreth 1 për qind të BPV-së për të treja vitet (2021, 2022 dhe 2023). Sipas këtyre projeksioneve dhe nën kufizimin se tejkalimit i deficitit mbi nivelin e lejuar në vitin 2020 duhet të kompensohet në vitet në vazhdim, është e qartë se hapësira fiskale për të akomoduar iniciativat të reja për transfere sociale është mjaft e limituar. Presioni i ngritur për përdorimin e parasë publike si rishpërndarje, sidomos kur një rishpërndarje e tillë nuk targeton varfërinë por jepet mbi kritere tjera, paraqet rrezik fiskal për një strategji fiskale që targeton zhvillim socio-ekonomik. Megjithatë, nëse situata pandemike do të vazhdojë më gjatë dhe ndikimi në ekonomi do të rezultojë të jetë ndjeshëm më negativ se ai i paraqitur në këtë version të KASH-it, atëherë do të jetë e pashmangshme një ri-organizim i shpenzimeve apo gjetja e burimeve të tjera të financimit për të akomoduar iniciativat të reja fiskale për të adresuar pasojat socio-ekonomike të pandemisë.

4. Rreziku fiskal nga mbledhja e të hyrave

Ashtu siç u përmend edhe tek rreziqet makroekonomike, situata e re e krijuar nga pandemia COVID-19 rëndon procesin e mbledhjes së të hyrave buxhetore. Nëse para pandemisë ekonomia jo-formale ka qenë një prej rreziqeve kryesore për mbledhjen e të hyrave, pas pandemisë një rrezik shtesë lidhet me paaftësinë e bizneseve apo ekonomive familjare të cilët nuk do të mund të paguajnë detyrime e veta për shkak të përkeqësimit të situatës së tyre financiare.

Një rrezik i rëndësishëm fiskal i lidhur me të hyrat tatimore është se a mund të mbledhen tatimet e arkëtueshme apo jo. Sipas raportit vjetor financiar për vitin 2019, llogaritë e arkëtueshme të pa mbledhura arrinin në 634 milionë euro, 452 prej të cilave lidheshin me nivelin e qeverisë qendrore dhe 182 me nivelin e qeverisë lokale. Këto 634 milionë euro të llogarive të arkëtueshme të pa mbledhura paraqesin një rritje të lehtë krahasuar me vitin paraardhës, me rreth 23 milionë euro). Rritja mesatare vjetore për periudhën 2016-2019 arrin në 7.2%, me rritjen më të ngadaltë të shënuar në vitin 2019 (3.8%).

5. Detyrimet e papaguara

Neni 39 i Ligjit për MFP përcakton se detyrime të papaguara janë pagesat që kanë kaluar afatin e pagesës mbi 30 ditë. Ndryshe nga viti i kaluar, raporti vjetor financiar i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019 përfshin një aneks për detyrimet e papaguara të cilat përfshijnë zotimet financiare, llogaritë e pagueshme dhe detyrimet e papaguara, duke e bërë ndarjen e këtyre shumave në dy kategori sipas vjetërsisë: i) më pak se 30 ditë; dhe ii) më shumë se 30 ditë.

Tabela 7 paraqet detyrimet e papaguara (>30 ditë) për tre vite sipas nivelit qendror dhe lokal. Në vitin 2019, vihet re një rënie e lehtë e detyrime të papaguara në total, duke zbritur nga 88.3 milionë Euro në vitin 2018 në 79 milionë Euro në vitin 2019, kryesisht si rezultat i rënies në detyrimet e papaguara në nivelin lokal. Në nivelin qendror, pjesa më e madhe e detyrimeve të papaguara (> 30 ditë) i atribuohet më së shumti Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (e cila ka shënuar rritje të ndjeshme nga viti 2018 në 2019) dhe Ministrisë së Infrastrukturës (detyrimet e së cilës janë përgjysmuar nga viti 2018 në 2019). Në nivelin lokal, në vitin 2019, komunat e Prizrenit dhe Gjilanit janë dy komunat, të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të detyrimeve të papaguara (> 30 ditë). Rënia e detyrimeve në nivelin lokal në 2019 i atribuohet kryesisht rënies së detyrimeve të papaguara në komunën e Prishtinës dhe Gjilanit. Në vitin 2019, detyrimet e papaguara përbënin 4.07% të shpenzimeve aktuale të organizatave buxhetore në nivelin qendror dhe rreth 3.06% në nivelin lokal, që së bashku përbëjnë 3.82% të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore.

Tabela 7 Detyrimet e papagura

	2017	2018	2019	2019/ Shpenzimi i përgjithshëm i OB-ve
Qeveria qendrore (mil Eur)	33.83	62.99	63.32	4.07%
<i>Ministria e Infrastrukturës</i>	22.6	38.5	15.4	7.83%
<i>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</i>	0.6	2.5	31.8	73.22%
<i>Fondi i Sigurimeve Shëndetësore</i>	4.0	6.0	9.8	104.40%
<i>Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve</i>	2.3	3.1	2.5	8.07%
Qeveria lokale (mil Eur)	18.8	25.3	15.7	3.06%
<i>Prishtinë</i>	1.3	7.5	0.1	0.18%
<i>Prizren</i>	3.3	2.2	1.3	3.08%
<i>Gjilan</i>	2.5	7.8	9.8	38.90%
Gjithsej (mil euro): Qendrore + Lokale	52.7	88.3	79.0	3.82%
Gjithsej pagesa/gjithsej shpenzime buxhetore %	3.0%	4.50%	3.82%	

6. Rreziqet fiskale nga rastet gjyqësore

Një tregues i rëndësishëm i rreziqeve fiskale nga rastet gjyqësore është zhvillimi i pagesave vjetore të qeverisë për vendimet e gjykatave. Tabela 8 paraqet pagesat sipas vendimeve të gjykatave gjatë katër viteve të fundit, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Në përgjithësi, pagesat për vendimet gjyqësore nuk përbëjnë më shumë se 2% të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit, edhe pse tregojnë një trend në rritje përgjatë viteve, si në nivel lokal ashtu edhe atë qendror.

Shumica e kostove për rastet gjyqësore në tre vitet e fundit rrjedhin nga niveli i pushtetit lokal. Pagesat për vendimet e gjykatave në nivelin qendror kryesisht i atribuohen Ministrisë së Financave (në emër të shpronësimit për MMPH-së¹⁸), Ministrisë së Administrimit Publik, Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, dhe Agjencisë Kosovare për Krahësimin dhe Verifikimin e Pronës. Në nivel lokal, komunat Ferizaj, Leposaviq, Mitrovicë dhe Prishtinë përbëjnë pjesën më të madhe të këtyre pagesave. Në vitin 2019, pagesat e bazuara në vendimet e gjykatave përbënin 0.67% të shpenzimeve aktuale të organizatave buxhetore në nivelin qendror dhe rreth 2.99% në nivelin lokal, që së bashku përbëjnë 1.25% të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore. Për të pasur një pasqyrë më të plotë të rreziqeve fiskale që burojnë nga kostot e rasteve gjyqësore, do të duhet të dihet sa janë të mëdha kostot që do të mund të dalin nga rastet që janë në proces e sipër në gjykatë.¹⁹

Tabela 8 Pagesat bazuar në vendimet gjyqësore (milion Eur)

	2016	2017	2018	2019	2019/ Shpenzimi i përgjithshëm i OB-ve
Qeveria qendrore (mil Eur)	4.11	5.26	7.59	10.5	0.67%
<i>Ministria e Financave</i>	4.5%	1.9%	0.5%	27.5%	9.33%
<i>Ministria e Administratës Publike</i>	0.9%	1.2%	0.1%	12.2%	4.33%
<i>Shërbim Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës</i>	1.3%	5.0%	4.0%	11.6%	0.98%
<i>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor</i>	51.8%	46.5%	31.3%	5.6%	1.34%
<i>Agjenci Kosovare për Krahësimin dhe verifikim të Pronës</i>	0.6%	-	7.9%	5.7%	22.32%
Qeveria lokale (mil Eur)	2.2	6.3	12.7	15.3	2.99%
<i>Komuna Ferizaj</i>	7.2%	17.3%	22.9%	29.7%	14.31%
<i>Komuna Leposaviq</i>	0.0%	3.2%	17.6%	8.7%	31.10%
<i>Komuna Mitrovicë</i>	6.7%	8.6%	8.3%	9.7%	7.66%
<i>Komuna Prishtinë</i>	18.3%	14.1%	5.2%	8.0%	1.56%
Gjithsej (mil euro): Qendrore + Lokale	6.34	11.54	20.26	25.83	1.25%
Gjithsej pagesa/gjithsej shpenzime buxhetore, %	0.38%	0.66%	1.04%	1.25%	

¹⁸ Ministria e Mjedisimit dhe Planifikimit Hapësinor

¹⁹ KASH-i i ardhshëm do të përfshijë informacione më të detajuara për pagesat kryesore për vendimet e gjykatave dhe do të përpiqet të kuantifikojë madhësinë e kostove që mund të krijohen nga rastet që janë në proces e sipër në gjykata.

PJESA E TRETË

3. KORNIZA E SHPENZIMEVE SEKTORIALE 2021-2023 – QEVERTIA QENDRORE

Siç mund të shihet, në pjesën e parë të këtij dokumenti janë prezantuar prioritetet qeveritare në lidhje me KASH 2021-2023, ku është theksuar se prioritetet rrjedhin nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim, Programi Qeveritar, Programi për Reforma në Ekonomi 2020-2022, Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, si dhe dokumente tjera strategjike sektoriale. Kurse, në vijim të dokumentit do të paraqiten objektivat kryesorë sipas sektorëve të nivelit qendror ku janë paraqitur gjithsejtë 10²⁰ sektorë ku secili sektor ka të prezantuar trendin e financimit 2019-2020 dhe vlerësimet buxhetore për periudhën e ardhshme trevjeçare 2021-2023. Në kuadër të secilit sektor janë të paraqitura edhe organizatat buxhetore sipas sektorëve përkatës. Tabelat e mëposhtme paraqesin projeksionet për vitet 2021-2023 për buxhetin e përgjithshëm të Kosovës, në nivel qendror dhe sipas sektorëve. Në pjesën e katërt të dokumentit është paraqitur financimi komunal.

Në lidhje me projeksionet e shpenzimeve buxhetore për periudhën e ardhshme afatmesme 2021-2023, janë tri elemente kyçe që organizatat buxhetore duhet të kenë parasysh. E para, që organizatat buxhetore mund të planifikojnë shpenzime brenda kufijve të dhënë vetëm pasi të mbulojnë detyrimet kontraktuale, tek pastaj hapësirën e lirë brenda kufijve mund ta shfrytëzojnë për prioritetet tjera. E dyta, kufijtë buxhetor të vlerësuar me këtë dokument, mund të ndryshojnë përmes qarkores së tretë buxhetore, si rrjedhojë e ndryshimit të rrethanave makroekonomike në kuptim të daljes nga pandemia COVID 19. E treta, projeksioni i shpenzimeve në kategorinë e pagave dhe shtesave për vitin 2021 mund të pësojë ndryshim si rrjedhojë e vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me Ligjin e Pagave në Sektorin Publik.

Tabela 9 Trendet e Financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021-2023

Buxheti i Përgjithshëm i Kosovës	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Buxhetuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	2,069,971,611	2,356,860,924	2,276,309,640	2,373,508,890	2,373,892,259
Numri i punëtorëve	84,621	85,425	85,438	85,438	85,438
Paga dhe shtesa	615,933,279	619,203,936	638,684,627	642,094,325	645,304,796
Mallra dhe shërbime	270,687,394	326,424,093	323,261,272	324,739,790	333,447,044
Shpenzime komunale	24,863,550	30,545,232	30,074,162	30,558,405	31,058,405
Subvencione dhe transfere	627,271,358	632,752,862	631,335,357	639,835,357	651,755,357
Shpenzime kapitale	531,216,030	671,808,032	599,054,222	684,181,013	650,626,657
Rezerva	0	44,126,769	7,800,000	7,800,000	7,800,000
Interesi		32,000,000	46,100,000	44,300,000	53,900,000

²⁰ Sektorët janë paraqitur sipas Klasifikimit të Funksioneve të Qeverisë (COFOG), hartuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD).

Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	1,853,157,879	2,023,371,503	1,986,872,983	2,100,207,818	2,177,724,368
Të hyrat vetanake	60,748,156	95,728,712	96,349,865	103,264,138	106,122,246
Financimi nga të hyrat e AKP-së	127,683,360	85,000,000	-	-	-
Te hyrat e dedikuara	6,458,847	10,395,233	9,600,547	10,798,867	15,098,867
Financimet nga huamarrjet	28,382,216	120,760,709	146,986,792	125,736,934	36,145,645
Financimi nga deficitit buxhetor (2%) - 04	20,895,548	45,915,471	14,921,300	5,400,000	9,700,000
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	7,486,668	74,845,238	132,065,492	120,336,934	26,445,645
Grantet nga Donatorët *	1,066,557	265,910	-	-	-

Tabela 10 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023 për nivelin qendror

Totali i Nivelit Qendror	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	1,556,668,330	1,745,118,203	1,675,763,560	1,711,508,890	1,684,502,259
Numri i punëtorëve	40,418	41,076	41,076	41,076	41,076
Paga dhe shtesa	352,506,964	345,303,705	360,914,895	362,935,745	364,750,423
Mallra dhe shërbime	206,297,829	250,681,347	241,018,526	241,197,044	251,447,044
Shpenzime komunale	14,185,170	19,017,475	18,546,405	18,558,405	18,558,405
Subvencione dhe transfere	605,303,149	619,262,004	616,335,357	622,835,357	633,755,357
Shpenzime kapitale	378,375,218	500,973,672	431,148,377	458,182,340	408,191,031
Rezerva	-	9,880,000	7,800,000	7,800,000	7,800,000
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	1,396,239,406	1,527,880,128	1,507,489,485	1,561,760,956	1,620,045,614
Të hyrat vetanake	6,354,433	12,612,133	13,212,133	13,212,133	13,212,133
Të hyrat nga AKP	127,683,360	85,000,000	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	6,458,847	10,395,233	9,600,547	10,798,867	15,098,867
Financimet nga huamarrjet	19,932,284	109,230,709	145,461,395	125,736,934	36,145,645

Financimi nga deficitin buxhetor (2%) - 04	19,860,584	45,915,471	14,921,300	5,400,000	9,700,000
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	71,700	63,315,238	130,540,095	120,336,934	26,445,645
Grantet nga Donatorët *	1,066,557	265,910	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.1 QEVERIA E PËRGJITHSHME

Synimet kryesore në kuadër të këtij sektori janë qeverisja e mirë, administrata publike profesionale, zhvillimi socio-ekonomik dhe avancimi i proceseve integruese të vendit. Objektivat kryesorë gjatë periudhës së ardhshme trevjeçare 2021-2023 në kuadër të këtij sektori janë:

- Sigurimi i njohjeve të reja, forcimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës dhe zbatimi i kriterëve në procesin e integritetit në BE dhe institucione ndërkombëtare;
- Ruajtja e qëndrueshmërisë makro-fiskale, zhvillimi dhe përsosja e sistemit të vjeljes dhe administrimit të të hyrave tatimore dhe doganore dhe zvogëlimi i ekonomisë joformale;
- Ngritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike;
- Standardizimi dhe thjeshtëzimi i procedurave administrative dhe thellimi i luftës kundër korrupsionit;
- Avancimi i sistemit të prokurimit elektronik dhe ngritja e cilësisë së menaxhimit të financave publike;
- Zhvillimi i balancuar dhe rritja e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar;
- Siguria e ushqimit dhe ruajtja e shëndetit publik.

Organizatat buxhetore të cilat e përbëjnë Sektorin e Qeverisë së Përgjithshme Publike janë: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Zyra e Presidentit, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Transfereve (përfshihen ndarjet buxhetore që kanë të bëjnë me skemat pensionale dhe sociale), Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (përfshihen vetëm ndarjet buxhetore që kanë të bëjnë me Administratën Publike), Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria për Integritet Evropian, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, Agjencioni Kundër Korrupsionit, Organi Shqyrtues i Prokurimit, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, Agjencia për Informim dhe Privatësi, Zyra Kombëtare e Auditimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Në këtë sektor bëjnë pjesë edhe Shpenzimet e Paparashikuara.

Tabela 11 Trendet e Financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Qeverisja e Përgjithshme

Sektori i Qeverisjes së Përgjithshme Publike	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuara	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	145,498,054	223,860,948	191,474,453	181,922,014	199,942,029
Nr. i punëtorëve	4,078	4,332	4,332	4,332	4,332
Pagat dhe Shtesat	45,852,294	46,939,855	49,162,717	49,732,894	50,082,908
Mallrat dhe Shërbimet	55,297,511	71,615,748	66,060,838	61,129,721	71,379,721
Shpenzimet Komunale	3,515,612	5,104,446	5,074,446	5,074,446	5,074,446
Subvencionet dhe Transferet	12,183,797	21,577,000	20,310,000	20,310,000	26,230,000
Shpenzimet Kapitale	28,648,840	71,823,899	46,066,452	40,874,954	42,374,954
Rezerva	-	6,800,000	4,800,000	4,800,000	4,800,000
Burimet e Financimit					
Grantet qeveritare	133,810,877	212,629,896	187,293,767	176,741,328	190,461,343
Të hyrat vetanake	286,656	180,686	180,686	180,686	180,686
Të hyrat nga AKP-ja	11,400,522	6,355,000	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	4,695,366	4,000,000	5,000,000	9,300,000
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04	-	4,695,366	4,000,000	5,000,000	9,300,000
Financimi nga klauzola e investimeve - 06	-	-	-	-	-
Grantet nga donatorët*	490,506	265,910	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.2 MBROJTJA

Sektori i Mbrojtjes ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave të përgjithshme shtetërore të mbrojtjes në nivelin strategjik, si dhe të ushtrijë funksionet dhe kompetencat e saj në përputhje me Strategjinë e Sigurisë së Republikës së Kosovës dhe Strategjinë e Mbrojtjes, si dhe legjislacionin në fuqi. Misioni i Ministrisë së Mbrojtjes është që të hartoj, planifikoj, menaxhoj, mbikëqyrë, zgjerojë, zbatojë, vlerësojë dhe zhvillojë politikat e përgjithshme shtetërore të mbrojtjes brenda kornizës së qeverisjes demokratike dhe në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Që nga viti 2019 për Ministrinë e Mbrojtjes (MM) dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) është hapur një kapitull i ri i cili ndërlidhet me realizimin e synimeve tona, aprovimi i Ligjit për Ministrinë e Mbrojtjes, Ligjit për FSK dhe Ligjit për Shërbimin në FSK, ligje këto të cilat zgjerojnë misionin e FSK-së si forcë ushtarake profesionale me kompetenca dhe detyra për mbrojtjen e integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Në kuadrin e përmbushjes së objektivave të parapara në Planin Gjithëpërfshirës të Tranzicionit (PGJT), MM dhe FSK gjenden

në vitin e dytë të tranzicionit (faza e parë) e cila përcakton ngritjen e njësive me prioritet dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për përmbushje të misionit kushtetues dhe ligjor.

Mjedisi aktual dhe i ardhshëm strategjik, global, rajonal dhe i brendshëm i sigurisë, kërkon fleksibilitet dhe veprime, vendime në kohë për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse për Republikën e Kosovës, për t'u ballafaquar me shumëllojshmërinë e sfidave të sigurisë. Andaj MM dhe FSK duke përcjellur me vëmendje këto zhvillime do të adresoj kërkesat për projekte të reja ushtarake tek institucionet e Republikës së Kosovës. Bazuar në PGJT, prioritetet e caktuara për vitin e parë të tranzicionit janë realizuar me sukses të gjitha veprimet e planifikuara në aspektin administrativ. Mirëpo gjatë vitit 2018 dhe 2019 janë hasur sfida dhe vonesa procedurale për ekzekutimin e projekteve që ndërlidhen me blerjet ushtarake të planifikuara për arritjen e aftësive dhe kapaciteteve për mbrojtje të territorit. Një nga sfidat kryesore në këtë drejtim është edhe mungesa e kornizës ligjore për prokurim afatgjatë të pajisjeve dhe sistemeve ushtarake. MM/FSK mbetet në vazhdimësi e angazhuar për planifikim efektiv dhe efikas për zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive operationale të FSK-së në realizimin e operationeve, për mbrojtjen e territorit, të reagimit ndaj krizave në mbështetjen ushtarake autoriteteve civile dhe për pjesëmarrje në operationet ndërkombëtare.

Ministria e Mbrojtjes, bazuar në strategjinë e saj, e posaçërisht në rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë (RSSS), ka përcaktuar objektivat e saja të cilat janë:

- Vazhdimi i tranzicionit dhe planifikimi i mbrojtjes;
- Gatishmëria dhe operationet e Forcës për Sigurinë e Kosovës;
- Zhvillimi i kapaciteteve, standardizimi dhe modernizimi;
- Bashkëpunimi ndërinstitutional dhe ndërkombëtar dhe
- Fuqizimi i transparencës, llogaridhënies, integritetit dhe besueshmërisë.

Tabela 12 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023 –Sektori i Mbrojtjes

Sektori i Mbrojtjes	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	49,703,787	69,275,842	64,839,562	68,375,087	68,508,862
Numri i punëtorëve	3,455	3,636	3,636	3,636	3,636
Paga dhe shtesa	21,973,358	23,504,455	26,621,977	26,755,087	26,888,862
Mallra dhe shërbime	9,450,545	11,942,683	11,338,881	11,400,000	11,400,000
Shpenzime komunale	651,461	938,000	988,000	1,000,000	1,000,000
Subvencione dhe transfere			-	-	-
Shpenzime kapitale	17,628,423	32,890,704	25,890,704	29,220,000	29,220,000
Rezerva			-		
Burimet e financimit					

Garantet qeveritare	44,376,315	67,775,842	64,839,562	68,375,087	68,508,862
Të hyrat vetanake					
Të hyrat nga AKP - 24	5,327,472	1,500,000	-		
Të hyrat e dedikuara					
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga deficitit buxhetor (2%) - 04					
Financimi nga Klauzola e investimeve -06					
Grantet nga Donatorët *					

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.3 RENDI, LIGJI DHE SIGURIA PUBLIKE

Misioni i Sektorit të Ligjit, Rendit dhe Sigurisë Publike është të përgatisë politika publike, akte ligjore dhe standarde të detyrueshme në fushën e drejtësisë në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi si dhe të sigurojë sistem të pavarur, të paanshëm profesional dhe efektiv të sistemit prokurorial dhe gjyqësor. Pjesë e këtij misioni është edhe ndërtimi, ruajtja, ngritja si dhe mbrojtja e sigurisë së jetës dhe lëvizjes së lirë për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Ministria e Drejtësisë si bartëse e sektorit të ligjit do të udhëheq dhe zbatojë reforma dhe masa të ndryshme në lëminë e sundimit të ligjit, në mënyrë që të ngritet efikasiteti, llogaridhënia dhe gjithëpërfshirja në plotësimin e nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve në lëminë e sundimit të ligjit. Ky sektor është i përkushtuar të përmbush obligimet që rrjedhin nga disa dokumente strategjike dhe të planifikimit, përfshirë: Programin e Qeverisë 2020-2023, Strategjinë Kombëtare për zhvillim 2016-2021, Programin e Kosovës për Reforma në Ekonomi 2020, Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) dhe Programin Legjislativ për Vitin 2020. Duhet cekur që aktualisht kemi hyrë në fazën përfundimtare të procesit të Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Ky proces ka për synim kryesor identifikimin e problemeve kryesore të cilat pengojnë funksionimin e mirëfillt të sundimit të ligjit dhe rrjedhimisht, adresimin e tyre përmes masave të qarta dhe të menduara mirë, të cilat do të arrijnë sigurimin e mbarëvajtjes së këtij sektori dhe ngritjen e besimit të qytetarëve në drejtësi. Në fund, ky proces do të kurorëzohet me hartimin e Strategjisë Sektoriale për Sundimin e Ligjit. Sektori i Sigurisë Publike ka implementuar me sukses politikat e saja në drejtim të përmbushjes së objektivave të parapara për vitin 2020. Lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit, mbrojtja e sigurisë publike, ngritja e sigurisë së dokumenteve dhe përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve kanë qenë ndër prioritetet kryesore të MPB-së.

Për të avancuar politikat e nevojshme për përmbushjen e objektivave, është miratuar Strategjia Shtetërore Kundër Krimin të Organizuar 2018-2022, Strategjia Shtetërore kundër Narkotikëve 2018-2022 dhe Strategjia Shtetërore kundër Terrorizmit 2018-2022. Ministria e Punëve të Brendshme është duke vazhduar aktivitetet dhe përpjekjet për anëtarësim në Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale INTERPOL si dhe nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin në Zbatimin e Ligjit EUROPOL.

Në fushën e luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar dhe korrupsionit ministria ka zbatuar politikat e saj. Policia e Kosovës gjatë vitit 2019 ka evidentuar 40,128 raste, prej të cilëve 26,895 vepra penale të natyrave të ndryshme dhe janë arrestuar 9348 persona. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2018, numri i rasteve ka shënuar rënie për 8.81% dhe rënie të veprave penale për 16.27%. Me qëllim të fuqizimit të masave parandaluese të ekstremizmit të dhunshëm si dhe de-radikalizimit dhe ri-integrimit të personave të kthyer nga zonat e konfliktit, Divizioni për Parandalim dhe Riintegrim të personave të radikalizuar brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme ka përgatitur dhe ofruar pakot standarde të shërbimeve për personat e kthyer nga zonat e konfliktit.

Objektivat kryesorë strategjik në kuadër të sektorit të rendit, ligjit dhe sigurisë publike janë:

- Fuqizimi i sundimit të ligjit nëpërmjet rishikimit të sistemit të drejtësisë dhe respektimi i të drejtave të njeriut;
- Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe institucionale të sistemit të drejtësisë;
- Lufta kundër krimin të organizuar, korrupsionit, dhe terrorizmit si dhe menaxhimi efikas i migrimit dhe kontrolli kufitar;
- Ngritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike përmes ngritjes së kapaciteteve të Qeverisjes Elektronike (Qendra e të dhënave Shtetërore, Rrjeti Shtetëror dhe Sistemet elektronike);
- Garantimi i pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës;
- Administrimi më efikas i sistemit të ekzekutimit të sanksioneve penale;
- Ruajtja e sigurisë publike dhe përmirësimi i shërbimeve për qytetarët;
- Rritja e cilësisë së kornizës ligjore për lehtësimin dhe funksionimin më të mirë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës;
- Fuqizimi i kapaciteteve institucionale dhe profesionale për ngritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të administrimit të sistemit prokurorial dhe gjyqësor;
- Hetimi dhe trajtimi i rasteve sipas parastresave, bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dispozitave të tjera ligjore dhe sipas konventave të ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si përgjegjësi themelore në funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe
- Ofrimi i ndihmës juridike falas, duke siguruar qasje të barabartë në drejtësi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, veçanërisht për grupet e marginalizuara.

Për arritjen e objektivave më lart, do të vazhdohet me implementimin e aktiviteteve, respektivisht veprimeve konkrete, të identifikuara në shumë prej dokumenteve strategjike të këtij sektori. Organizatat buxhetore të cilat janë pjesë e Sektorit të Rendit, Ligjit dhe Sigurisë Publike janë: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli

Prokurorial i Kosovës, Agjencia Kosovare e Inteligjencës, Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Tabela 13 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023 – Sektori i Rendit, Ligjit dhe Sigurisë Publike

Sektori i Rendit, Ligjit dhe Sigurisë Publike	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	203,832,368	213,789,460	211,082,519	219,765,284	220,360,010
Numri i punëtorëve	15,695	16,034	16,044	16,044	16,044
Paga dhe shtesa	140,776,684	133,842,124	138,419,406	139,013,979	139,608,705
Mallra dhe shërbime	37,157,346	41,972,767	40,825,044	42,121,738	42,121,738
Shpenzime komunale	2,913,340	3,796,199	3,796,199	3,796,199	3,796,199
Subvencione dhe transfere	2,508,039	9,869,367	10,069,367	10,069,367	10,069,367
Shpenzime kapitale	20,476,959	24,309,003	17,972,503	24,764,001	24,764,001
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	191,936,907	209,126,873	208,419,932	217,102,697	217,697,423
Të hyrat vetanake	2,254,254	2,662,587	2,662,587	2,662,587	2,662,587
Të hyrat nga AKP	9,641,207	2,000,000	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04	-	-	-	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-	-	-	-	-
Grantet nga Donatorët *	-				

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.4 ÇËSHTJET EKONOMIKE

Në kuadër të këtij sektori synohet që resurset njerëzore, natyrore, fizike dhe financiare të përdoren në mënyrë efektive dhe efikase për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm socio-ekonomik. Objektivat kryesorë në kuadër të sektorit për periudhën e ardhme trevjeçare janë:

- Krijimi i kushteve të favorshme për rritjen e produktivitetit të brendshëm dhe konkurrencën e eksportit si dhe investimi në mbrojtjen e pronësisë industriale dhe në sistemin e infrastrukturës së cilësisë;
- Inkurajimi i investimeve dhe eksportit, mbikëqyrja e tregut dhe mbrojtja e konsumatorit;

- Siguria e furnizimit të qëndrueshëm me energji, diversifikimi i burimeve të energjisë dhe zbatimi i masave të efikasitetit në ndërtesat e sektorit publik dhe në sektorin e shërbimeve, amvisërisë, industrisë dhe transportit;
- Hartimi i politikave strategjike për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit mineral dhe parandalimi dhe ndalimi i ekonomisë joformale në sektorin e minierave;
- Përshtetimi i qasjes dhe përdorimi i Teknologjisë Informatike dhe Komunikuese përmes shtrirjes brezgjere dhe avancimit të kapitalit njerëzor për të siguruar gjithpërfshirje dhe njëkohësisht për të maksimizuar përfitimet e ekonomisë dixhitale në tregun global;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore dhe zhvillimi i infrastrukturës hekurudhore;
- Ngritja e nivelit të sigurisë në komunikacion;
- Normalizimi i hapësirës së plotë ajrore të Kosovës;
- Rritja e produktivitetit bujqësor, rritja e aftësisë konkurruese në bujqësi si dhe rritja e potencialit prodhues të fermave;
- Përmirësimi dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe funksioneve të tyre;
- Avancimi i ndërmarrësisë dhe iniciativës private përmes inovacioneve me fokus në zhvillimin e NVM-ve prodhuese dhe shërbyese;
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe zvogëlimi i punësimit joformal përmes fuqizimit të mekanizmave të mbikëqyrjes dhe forcimit të dialogut social.

Organizatat buxhetore që bëjnë pjesë në sektorin për çështje ekonomike janë: Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (ndarjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Zyra Rregullative e Energjisë, Autoriteti Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave, Autoriteti i Aviacionit Civil, Agjensioni për Shërbimet e Navigacionit Ajror, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe Agjensioni Kosovar i Privatizimit.

Tabela 14 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i çështjeve ekonomike

Sektori i Çështjeve Ekonomike	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	304,767,277	363,681,048	365,583,022	384,849,690	340,968,026
Numri i punëtorëve	2,071	2,194	2,194	2,194	2,194
Paga dhe shtesa	18,215,538	21,696,278	21,812,572	21,929,027	22,038,672
Mallra dhe shërbime	20,681,914	32,179,895	29,250,466	36,634,412	36,634,412
Shpenzime komunale	527,075	1,089,943	1,167,833	1,167,833	1,167,833
Subvencione dhe transfere	63,379,700	86,299,706	68,329,706	70,329,706	70,329,706
Shpenzime kapitale	201,963,050	219,335,226	242,022,445	251,788,712	207,797,403
Rezerva	-	3,080,000	3,000,000	3,000,000	3,000,000
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	216,007,394	243,017,069	232,897,225	271,930,734	311,440,359

Të hyrat vetanake	110,151	183,155	183,155	183,155	183,155
Të hyrat nga AKP - 24	64,923,214	25,000,000	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	6,458,847	5,699,867	5,600,547	5,798,867	5,798,867
Financimet nga huamarrjet	17,267,672	89,780,957	126,902,095	106,936,934	23,545,645
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04	17,195,972	33,627,719	10,000,000	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	71,700	56,153,238	116,902,095	106,936,934	23,545,645
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.5 MJEDISI

Në kuadër të këtij sektori synohet zhvillimi i balancuar dhe i qëndrueshëm duke siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e planifikimit të mirëfilltë hapësinor përmes monitorimit, informimit dhe raportimit mjedisor. Kosova ballafaqohet me problemet e menaxhimit të ujit, të mbeturinave, ndotjes së ajrit dhe tokës. Problemet tjera të mjedisit shkaktohen nga zhvillimet e paplanifikuara hapësinore dhe ndërtimet pa leje të cilat dëmtojnë hapësirën dhe ulin mundësitë për zhvillimin e ardhshëm të vendit. Përderisa gjatë periudhës së fundit, janë bërë përpjekje që sado pak të adresohen sfidat që lidhen me këto probleme, akoma mbetet shumë për tu bërë. Për sa i përket periudhës së ardhshme, Qeveria synon të ndërmarr veprime konkrete për përmirësimin e gjendjes aktuale. Objektivat kryesorë të sektorit të mjedisit janë:

- Kompletimi i infrastrukturës ligjore në fushën e mjedisit dhe harmonizimi i tyre me legjislacionin e BE-së dhe zbatimin e saj;
- Përmirësimi i gjendjes së mjedisit dhe monitorimi i gjendjes së tij;
- Krijimi i sistemit administrativ efikas për planifikim hapësinor, ndërtim, banim, efikasitet të energjisë në ndërtesa dhe kadastrë;
- Administrimi dhe menaxhimi më i mirë i resurseve ujore dhe rehabilitimi i shtretërve të lumenjve dhe menaxhimi i mbeturinave;
- Fuqizimi i inspektoriatit mjedisor, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor, banimit dhe ndërtimit;
 - Avancimi i politikave tarifore, ngritja e standardeve të shërbimit të ujit dhe zvogëlimi i humbjeve të ujit dhe
 - Fuqizimi i Shpronësimit në nivel nacional.

Objektivat e listuar më lart do të arrihen duke u fokusuar në implementimin e veprimeve konkrete të fushës, si për shembull fillimisht hartimi i legjislacionit primar e sekondar, parandalimi dhe zvogëlimi i ndotjes së mjedisit dhe qasjes së integruar për kontrollin e ndotjes dhe monitorimin e zbatimit të lejeve mjedisore, përmirësimi i monitorimit dhe raportimit për cilësinë e ajrit, etj.

Tabela 15 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Mjedisit

Sektori i Mjedisit	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	43,824,594	53,233,919	30,254,789	40,261,060	29,770,128
Numri i punëtorëve	354	329	329	329	329
Paga dhe shtesa	2,437,442	1,810,693	1,811,933	1,813,599	1,822,667
Mallra dhe shërbime	1,479,144	4,202,270	2,963,345	2,249,550	2,249,550
Shpenzime komunale	60,581	74,723	74,723	74,723	74,723
Subvencione dhe transfere	200,000	200,000	200,000	200,000	200,000
Shpenzime kapitale	39,647,427	46,946,233	25,204,788	35,923,188	25,423,188
Rezerva					
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	30,495,635	24,671,919	16,216,789	26,461,060	26,470,128
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-
Financimi nga të hyrat e AKP-së	13,328,959	22,000,000	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	6,562,000	14,038,000	13,800,000	3,300,000
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04	-	400,000	400,000	400,000	400,000
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-	6,162,000	13,638,000	13,400,000	2,900,000
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.6 ÇËSHTJET E BANIMIT DHE KOMUNITETIT

Në kuadër të këtij sektori synohet krijimi i kushteve për kthim të qëndrueshëm të zhvendosurve, mbrojtja, integrimi dhe zhvillimi i komuniteteve që jetojnë në Kosovë, si dhe zgjidhja e çështjeve pronësore që lidhet me dokumentet kadastrale origjinale të para qershorit të vitit 1999.

Për sa i përket këtij sektori, objektivat kryesorë për periudhën e ardhshme trevjeçare janë:

- Kthimi, riintegrimi në Kosovë dhe ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për funksionimin normal të të kthyerve;
- Stabilizimi i komuniteteve dhe mbyllja e qendrave kolektive në Kosovë;
- Pranimi, krahasimi dhe zgjidhja e dallimeve në mes të dokumenteve kadastrale të marra nga autoritetet e Serbisë dhe dokumenteve aktuale kadastrale në Kosovë për pronën private, komerciale dhe bashkësive fetare;
- Zbatimin e vendimeve të Komisionit të Kërkesave Pronësore të Kosovës dhe vendimeve të Gjykatës Supreme, shkatërrimin e strukturave të paligjshme në pronat private dhe administrimin e skemës së qirasë.

Këto objektiva do të arrihen përmes ndërmarrjes së veprimeve konkrete: ndërtimin e shtëpive për të kthyerit, ndërtimin e ndërtesave banesore kolektive, ndërtimin e shkollave dhe qendrave shëndetësore, ndërtimin e rrugëve dhe sistemeve të ujitjes e kanalizimit, etj. Organizatat buxhetore që e përbëjnë sektorin për çështjet e banimit dhe komuniteteve janë: Ministria për Komunitete dhe Kthim si dhe Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronave.

Tabela 16 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Çështjeve të Banimit dhe Komunitetit

Sektori i Çështjeve të Banimit dhe Komunitetit	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	9,992,742	9,927,519	7,434,548	6,922,175	6,932,762
Numri i punëtorëve	304	320	320	320	320
Paga dhe shtesa	1,956,981	2,096,392	2,106,875	2,117,410	2,127,997
Mallra dhe shërbime	1,495,618	1,494,104	1,090,650	967,742	967,742
Shpenzime komunale	60,376	105,523	105,523	105,523	105,523
Subvencione dhe transfere	288,325	300,000	300,000	300,000	300,000
Shpenzimet kapitale	6,191,442	5,931,500	3,831,500	3,431,500	3,431,500
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit					
Garantet qeveritare	9,038,105	9,927,519	7,434,548	6,922,175	6,932,762
Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-
Financimi nga të hyrat e AKP-së	954,637	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga deficitet buxhetor (2%) - 04	-	-	-	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-	-	-	-	-
Grantet nga Donatorët *	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.7 SHËNDETËSIA

Në kuadër të këtij sektori synohet ruajtja e shëndetit, promovimi i mënyrave të shëndetshme të jetesës dhe ofrimi i shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë, pa rrezik financiar dhe kosto-efektive.

Me qëllim të vazhimit të reformës në sektorin e shëndetësisë dhe arritjen e objektivave të përcaktuar me Strategjinë Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 Ministria e Shëndetësisë në vitin 2019 është fokusuar në funksionalizimin e Fondit të Sigurimit Shëndetësor që është parakusht për krijimin e sistemit të qëndrueshëm të financimit në sektorin e shëndetësisë. Sektori i Shëndetësisë me qëllim të ruajtjes dhe përparimit të shëndetit si dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në vitin 2019 ka intensifikuar përpjekjet për krijimin e kushteve infrastrukturore dhe diagnostikuese për ofrimin e shërbimeve cilësore shëndetësore megjithatë realizimi i projekteve infrastrukturore ka hasur sfida dhe vonesa në të gjitha projektet si pasojë e mangësive në projektet fillestare dhe zbatimit jo adekuat nga operatorët ekonomik, me theks në projektin e emergjencës që është në proces gjyqësor. Në vitin 2018-2019 është filluar me shtrirjen e sistemit bazik të informimit shëndetësor në kujdesin parësor shëndetësor. Deri më tani sistemi bazik i informimit shëndetësor është shtrirë në 29 komuna dhe në 14 ambulanca specialistike. Sektori i Shëndetësisë në fillim të vitit 2020 është fokusuar tërësisht në marrjen e masave për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 me qëllim të ruajtjes së shëndetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Bazuar në Strategjinë Sektoriale Shëndetësore 2017-2021 dhe Programin e Qeverisë 2020-2023, synohet përmbushja e katër prioritetëve/objektivave strategjikë:

- Mbrojtja e shëndetit dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara shëndetësore;
- Riorganizimi i sektorit shëndetësor dhe
- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm shëndetësor.

Për arritjen e këtyre objektivave, do të ndërmerren veprime të tilla si ofrimi dhe përmirësimi i shërbimeve shëndetësore të arritshme dhe të barabarta, zbatimi i planit të veprimit për edukim dhe promovim shëndetësor, shëndeti i nënës e fëmijës, shëndeti riprodhues, zbatimi i vlerësimit të ndikimit të mjedisit në shëndet, funksionalizimi i plotë i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, zbatimi i Pakos themelore të shërbimeve shëndetësore dhe kontraktimi, zhvillimi i sistemit të informimit shëndetësor dhe integrimi i teknologjisë informative (në Harduerë dhe Softuerë) të të gjitha institucionet shëndetësore. Organizatat Buxhetore të cilat e përbëjnë këtë sektor janë: Ministria e Shëndetësisë, Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës dhe Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Tabela 17 Trendet e Financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Shëndetësisë

Sektori i Shëndetësisë	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	159,420,299	168,913,052	163,505,337	164,036,436	165,391,308
Numri i punëtorëve	8,364	8,581	8,571	8,571	8,571
Paga dhe shtesa	70,475,341	65,493,071	70,820,537	71,175,640	71,530,512

Mallra dhe shërbime	51,407,528	62,142,252	62,944,531	61,103,527	61,103,527
Shpenzime komunale	3,936,108	4,396,924	3,833,964	3,833,964	3,833,964
Subvencione dhe transfere	10,629,011	9,313,805	8,813,805	8,813,805	8,813,805
Shpenzime kapitale	22,972,311	27,567,000	17,092,500	19,109,500	20,109,500
Rezerva	-				
Burimet e financimit	-				
Garantet qeveritare	150,316,689	151,910,120	160,205,337	160,736,436	162,091,308
Të hyrat vetanake	-	3,300,000	3,300,000	3,300,000	3,300,000
Të hyrat nga AKP - 24	7,386,532	9,645,000	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	1,717,078	4,057,932	-	-	-
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04	1,717,078	4,057,932	-	-	-
Financimi nga Klauzola e investimeve -06	-				
Grantet nga Donatorët *	221,130				

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.8 REKREACIONI, KULTURA DHE RELIGJIONI

Në kuadër të këtij sektori synohet krijimi dhe zhvillimi i politikave, ambientit dhe mekanizmave të përshtatshëm për promovimin dhe rritjen e aktiviteteve sportive, kulturore dhe rinore, evidencimin, vlerësimin e mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit.

Objektivat kryesorë të Sektorit Rekreacioni, Kultura dhe Religjioni janë:

- Mbështetja e kulturës së pavarur, përkrahja e veprimtarisë botuese si dhe avancimi i diplomacisë kulturore;
- Avancimi i sistemit ligjor dhe institucional të mbrojtjes, ruajtjes së trashëgimisë kulturore, përafrimin e vazhdueshëm me legjislacionin e BE-së si dhe angazhimet karshi Prioriteteve të Partneritetit Evropian dhe anëtarësimit në UNESCO;
- Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar, studimi dhe interpretimi objektiv dhe inkluziv i vlerave socio-kulturore dhe ekonomike, rritja e numrit të botimeve, guidave, medimeve virtuale e digjitale për promovimin e trashëgimisë kulturore;
- Krijimi, pasqyrimi, mbrojtja, klasifikimi, përpunimi, shfrytëzimi dhe ruajtja e dokumentacionit arkivor me vlerë historike e shkencore;
- Projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e komplekseve memoriale;
- Aktivizimi dhe mobilizimi i të rinjve për pjesëmarrje e përfaqësim aktiv, përgatitja e të rinjve për treg të punës dhe ofrimi i një mjedisi të shëndoshë dhe të sigurtë për të rinjtë;
- Mbështetja financiare e federatave sportive, masivizimi, zhvillimi i sportit cilësor për të gjithë dhe ngritja e infrastrukturës sportive sipas standardeve ndërkombëtare dhe

- Rregullimi, menaxhimi dhe mbikëqyrja e spektrit të frekuencave të transmetimit dhe digjitalizimit të RTK-së, dhe implementimi i transmetimit tokësor televiziv digjital.

Organizatat buxhetore që përbëjnë sektorin e rekreacionit, kulturës dhe religjionit janë: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, Komisioni i Pavarur i Mediave dhe Radio-Televizioni i Kosovës.

Tabela 18 Trendet e financimit 2019- 2020 dhe vlerësimet 2021- 2023- Sektori i Rekreacionit, Kulturës dhe Religjionit

Sektori i Rekreacionit, Kulturës dhe Religjionit	Viti 2019 Shpenzimi	Viti 2020 Buxhetuar	Viti 2021 Vlerësuar	Viti 2022 Vlerësuar	Viti 2023 Vlerësuar
Total	47,116,582	60,125,265	49,820,821	50,999,578	51,028,432
Numri i punëtorëve	829	853	853	853	853
Paga dhe shtesa	5,588,734	5,713,559	5,742,126	5,770,837	5,799,691
Mallra dhe shërbime	2,218,658	3,114,270	2,863,687	3,013,733	3,013,733
Shpenzime komunale	349,506	498,458	498,458	498,458	498,458
Subvencione dhe transfere	23,028,383	18,161,550	17,476,550	16,976,550	16,976,550
Shpenzimet kapitale	15,931,300	32,637,428	23,240,000	24,740,000	24,740,000
Rezerva	-	-	-	-	-
Burimet e financimit					
Grantet qeveritare	39,992,846	48,569,875	49,765,431	50,944,188	50,973,042
Të hyrat vetanake	17,873	55,390	55,390	55,390	55,390
Të hyrat nga AKP-ja	7,105,863	11,500,000	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-
Financimet nga huamarrjet	-	-	-	-	-
Financimi nga deficit i buxhetor (2%) - 04	-	-	-	-	-
Financimi nga klauzola e investimeve - 06	-	-	-	-	-
Grantet nga donatorët*	-	-	-	-	-

* Grantet nga donatorët nuk janë pjesë e totalit të shpenzimeve sipas burimit të financimit

3.9 ARSIMI

Ky sektor ka synim zhvillimin e një shoqërie të bazuar në dije dhe shkathtësi konkurruese, e integruar në rrjedhat evropiane, me mundësi të barabarta për avancimin e secilit individ që të përgatiten e të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm shoqëror, ekonomik dhe politik në vend. Sektori i arsimit ka përgjegjësi shtetërore dhe qytetare në edukimin e mirëfilltë për t'i përgatitur si qytetarë të denjë dhe të dobishëm për vendin. Ky sektor është duke kaluar nëpër një proces reformues që ka për objektiv rritjen e pjesëmarrjes dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit. Është punuar në hartim të legjislacionit dhe janë miratuar akte të shumta ligjore e nënligjore, janë ndërtuar, renovuar shumë objekte arsimore dhe janë themeluar institucione të shumta të reja. Është punuar në përmirësimin e kurrikulave dhe në hartimin e sigurimin e teksteve të reja shkollore, të cilat duhet të mbështeten nga praktika të reja të mësimdhënies e të mësimnxënies. Gjithashtu synohet mbështetja e kërkimeve shkencore dhe pjesëmarrja në të gjitha aktivitetet e arsimit në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, për të arritur standardet evropiane. Qasja në përfitim të dijes, hulumtimeve shkencore, inovacionit dhe të përfitimit të shkathtësive, që janë në funksion zhvillimit të përsheptuar të shoqërisë sonë dhe aftësive konkurruese brenda dhe jashtë Kosovës në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Objektivat kryesore për të përmbushur qëllimet e sektorit të arsimit janë:

- Rritja e përfshirjes dhe parandalimi i braktisjes në arsimin parauniversitar;
- Menaxhimi cilësor dhe efikas i sistemit të arsimit, i bazuar në transparencë dhe në llogaridhënie;
- Zhvillimi i një sistemi funksional për sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- Ngritja e cilësisë së mësimdhënies përmes sistemit të qëndrueshëm për përgatitjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve;
- Avancimi i të nxënësve përmes mësimdhënies cilësore, duke zbatuar kurrikulën e bazuar në kompetenca dhe duke shfrytëzuar resurse mësimore të cilësisë së lartë;
- Arsimi dhe aftësimi profesional në përputhje me kërkesat e tregut të punës në vend dhe më gjerë dhe
- Ngritja e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së arsimit të lartë përmes nxitjes së përsosmërisë në mësimdhënie, kërkimit shkencor, inovacionit dhe ndërkombëtarizimit.

